

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.9/10, Shtator - Tetor 2020

SHËN TOMA I AKUINIT MBROJTËSI I TË GJITHA SHKOLLAVE TË LARTA TEOLOGJIKE!

Shën Toma i Akuinit (Thomas Aquinas), meshtar ,rregulltar, filozof, teolog dhe mësues i Kishës (1225-1274). Ai si i tille në liturgjinë kishtarë kremtohet me 28. Janar.

Sot më 28 janar Kisha e përkujton Shën Tomën Akuinin një prej mendimtarëve më të mëdhenj të Kishës, i cili lindi në vitin 1225 nga familja e Kontëve të Akuinit në rrethinat të Napolit të Italisë së jugut, biri i Landulfit dhe nënës Teodora nga fisnikët e normandisë Teate. Nga fëmijëria tregon një dëshirë të madhe për arsimim. Përfundoi studimet më parë në kuvendin e Monte Cassino-s dhe pastaj në Napoli. Mbasi hyri në Urdhrit e Etërve Predikues (Dominikanëve), gjatë vitit 1252 e dërgojnë në studime në Paris, pasi përfundoi studimet e tija në Paris dhe në Këln të Gjermanisë, në udhëheqjen e Shën Alberit të Madh bëhet ndër dijetarë më të mëdhenj jo vetëm urdhrit Dominikanë por i Kishës. Madje ligjëron në Paris , në Romë dhe në Napoli, por ai mbeti gjithherë i thjeshtë si dhe i përvuajtur Të gjitha tituj dhe nderimet kishtarë që i ofrohen i refuzon, dhe dëshiron të mbesin i vogël sipas virtyeteve të ungjillit të Krishtit.

Shkroi shumë vepra më një dituri dhe angazhimi të madh, veçanti njohura është Suma Teologjisë prej tre vëllimeve, (Summa contra Gentiles dhe Summa Theologiae), në të cilat e përpunon krejt teologjinë, duke merituar famë shumë të madhe si filozof dhe teolog. Përpunoi logjiken krishtere duke u mbështetur në Organonon e Aristotelit, dhe miratoi filozofinë e Platonit mbi idenë që është mbi materien. Kurse në gnoseologji mbështetet në pohimet e Aristotelit

Shën Toma ishte edhe mistik si dhe adhures Eukaristisë, ku i shkroi himnet e mrekullueshme. Vdiq në kuvendin cistercens të Fosanovës (Latina) më 7 mars 1274 në moshën 49 vjeçare, në rrugë për Lion duke shkuar në Koncilin e 2 Lyonit. Përkujtimi i tij kremtohet më 28 janar, dita në të cilën trupi i tij që mbartur në vitin 1369 për tu varrosur në Tuluzë (Toulouse). Papa Gjoni XXII e shpalli për shenjtë gjatë vitit 1323, kurse papa Piu V gjatë vitit 1567 për mësues i Kishës. Papa Pali VI me letrën e quajtur Lumen Ecclesiae e shpallë për pajtori (mbrojtësi) i të gjitha shkollave të larta teologjike dhe studenteve.





Papa Françesku SHPRESË PËR TË ARDHMEN	4
Mons. Angelo Massafra O.F.M. HYJI NA KA DHURUAR, KRIJIMIN!	6
Redaksia JETA KISHTARE DHE E ARDHMJË E SAJ	7
Redaksia KRIJIMI ËSHTË NJË DHURATË E HYJIT PËR NJERËZIMIN	9
Don Nosh Gjollaj CIKLI I NATËS DHE AI I DITËS	10
M. Marjeta Gjoka KRIJUESI, KRIJIMI, KRIJESA	13
Gustav Schorghofer S.I. TË ZBULOSH TË BUKURËN	16
Redaksia IMZOT ERNEST ÇOBA	20
Atë Ndue Kajtazi AT SHTJEFËN GJEÇOVI	21
Angelo Massafra O.F.M. MESHTARËVE DHE BESIMTARËVE	23
Kronisti ARQIPESHKVI NË SHALË – SHOSH	24
Moter Erminia 25 VJETORI MOTRAT OBLATA NË BARDHAJ	25
Fra Dario Ardillo KISHA E OBOTIT TË VJETËR DHE TË OBLIKËS	26
Kronisti 4 SHTATOR: DITA LUTJEJE PER LIBANIN	26
Kronisti PUNIMET NË KISHËN MESJETARE - PLLANË	27

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXIII, nr. 9/10 (535 - 536) Shtator - Tetor 2020

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Vlash Palaj
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon Nika

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

PAPA PROPOZON NJË PAKT TË RI GLOBAL EDUKATIV, "SHPRESË PËR TË ARDHMEN"

Në një videomesazh të transmetuar sot, në kuadrin e një takimi në Universitetin Papnor Lateranens, organizuar nga Kongregata vatikanase për Edukimin Katolik, Papa ripropozon "Paktin Global Edukativ". Nevojitet, pohon Françesku, një impenjim i ri edukativ për një botë ku "të mos ketë vend për këtë pandemi të keqe të kulturës së hedhurinave".

Vatikan, 13 tetor 2020.

Me patos, me fjalë të ndiera e me shqetësim të vërtetë për të ardhmen e njerëzimit, sidomos të brezit të ri, Papa Françesku i drejtohet sot gjithë botës, profesorëve, studentëve, familjeve, institucioneve, qeveritarëve, të mëdhenjve e të vegjëlve, me një videomesazh, në të cilin kërkon një Pakt të ri Global Edukativ. Shtatë propozime, fjalë si "model i ri kulturor", "katastrofa edukative", "e ardhmja jonë s'mund të jetë kjo", "vendime që e rithemelojnë historinë", largimi nga "rezultatet e standartizuara", "të mos presim gjithçka nga qeveritarët, do të ishte fëmijërore", "edukim cilësor", janë ato që të mbeten në mend, kur dëgjon Atin e Shenjtë. Videomesazhi i tij u paraqit gjatë një takimi të organizuar nga Kongregata vatikanase për Edukimin Katolik në Universitetin Papnor Lateranens të Romës, në lidhje të drejtpërdrejtë në internet, për shkak të masave kundër pandemisë së koronavirusit, e cila bëri të shtyhej ngjarja botërore, që ishte parashikuar për 14 majin e kaluar. Fjalët e Atit të Shenjtë u komentuan, në një videomesazh tjetër, nga drejtoresha e përgjithshme e Unesco-s, Audrey Azoulay, nga personalitete kishtarë dhe kulturore, si edhe nga disa studentë.

Katastrofa edukative

Pikërisht pandemia, vëren që në fillim Papa Françesku, përveç vështirësive në fushën e shëndetësisë, shkaktoi edhe krizë ekonomike e shoqërore. Ndër të tjera, vuajtën e vazhdojnë të vuajnë sistemet edukative në gjithë botën. Përgjigja e mësimdhënies në distancë, përmes internetit, sipas Atit të Shenjtë, nuk mund të jetë zgjidhja për të dalë nga kjo krizë.

"Platformat edukative informatike – nënvizon Papa në videomesazh – dëshmuar jo vetëm pabarazinë e theksuar në mundësitë edukative dhe teknologjike, por edhe se, për shkak të mbylljes në shtëpi e të mungesave të tjera, që ekzistojnë edhe më parë, shumë fëmijë dhe adoleshentë mbeten mbrapa në procesin e natyrshëm të zhvillimit pedagogjik. Sipas të

dhënave të fundit të agjencive ndërkombëtare, flitet për 'katastrofë edukative'".

E Papa jep disa shifra: 10 milion fëmijë mund të detyrohen të lënë shkollën, për shkak të krizës ekonomike shkaktuar nga koronavirusi. Që tani, më se 250 milion fëmijë janë përjashtuar nga çdo lloj veprimtarie formuese.

Model i ri kulturor

Para këtij realiteti dramatik, vëren Papa, e dimë se masat e nevojshme shëndetësore do të jenë të pamjaftueshme, nëse nuk do të shoqërohen nga një model i ri kulturor. Ai duhet të respektojë dinjitetin e njeriut, duhet të ketë parasysh ndërvlerësinë e popujve, të kujdeset për shtëpinë e përbashkët e të mbrojë paqen. Kriza është e tërësishme e nuk kufizohet në një sektor të vetëm. Pandemia – ky, mendimi i Papës – e ka bërë gjithë botën të kuptojë se është në krizë mënyra jonë për ta interpretuar realitetin dhe për të vendosur marrëdhënie ndërmjet nesh. Për të dalë nga kjo gjendje, nuk mjaftojnë recetat e thjeshta e as optimizmi i kotë. E Ati i Shenjtë propozon fuqinë shndërruese të edukimit. Nuk duhet të mungojmë në takimin me këtë çast historik, në të cilin edukimi duhet të hapë horizonte të reja drejt mikpritjes, solidaritetit ndërmjet brezave dhe vlerës së trashëndencës, duke farkëtuar një kulturë të re.

E ardhmja jonë nuk mund të jetë kjo!

"Ne mendojmë – thekson Papa Françesku - se



edukimi është një nga rrugët më të frytshme për humanizimin e botës e të historisë. Edukimi është, sidomos, çështje dashurie dhe përgjegjësie, që transmetohet në kohë, nga brezi në brez.

Prandaj, edukimi propozohet si ilaç i natyrshëm kundër kulturës individualiste, e cila, nganjëherë, degjeneron në një kult të vërtetë individi e në primatin e indiferencës. E ardhmja jonë nuk mund të jetë ndarja, varfërimi i aftësisë për të menduar e për të imagjinuar, i aftësisë për dialog e për mirëkuptim të ndërsjellë. E ardhmja jonë nuk mund të jetë kjo.

Sot, kemi nevojë për një periudhë të ripërtërirë impenjimi edukativ, që të përfshijë të gjitha grupet e shoqërisë”.

Të dëgjojmë britmën e brezave të rinj

Është fjala për një rrugë të gjithanshme, në të cilën ndeshemi me vetminë dhe mosbesimin për të ardhmen, që shkaktojnë ndër të rinjtë depresion, vese, agresivitet, urrejtje verbale, fenomene bullizmi. Në këtë udhë, kërkon Papa Françesku, nuk duhet të qëndrojmë indiferentë para plagës së dhunës dhe abuzimit të të miturve, fenomenit të vajzave, që martohen me zor dhe fëmijëve ushtarë, dramës së të miturve të shitur dhe të skillavëruar. Këtyre u shtohet edhe dhimbja për “vuajtjet” e planetit, shkaktoar nga një shfrytëzim pa mend e pa zemër, i cili ka sjellë një krizë serioze mjedisore dhe klimatike.

Vendime themeltare për një edukim jo të standartizuar

Ati i Shenjtë bën thirrje për të marrë vendime të fuqishme, themeltare, që ndryshojnë të ardhmen. Kjo është koha për të lidhur një Pakt Edukativ Global “për e me të rinjtë”, ku të përfshihen familjet, bashkësitë, shkollat e universitetet, institucionet, fetë, qeveritarët, mbarë njerëzimi, në formimin e njerëzve të pjekur. Papa kritikon botën e bazuar mbi rezultate të standartizuara, që marrin parasysh vetëm dobinë produktive, burokracinë që e shkëmben edukimin me arsimimin e thjeshtë e kërkon një kulturë të gjithanshme, pjesëmarrëse e poliedrike. Kërkon guximin për të ndikuar drejt e në zemrën e shoqërisë e për t'i dhënë jetë një kulture të re, një bote të ndryshme nga kjo e sotmja. Françesku uron pjesëmarrjen e të gjithëve, njerëzve të kulturës, të shkencës e të sportit, të artistëve, të veprimtarëve të medias, që me dëshminë dhe me punën e tyre të bëhen promovues të kujdesit, të paqes, të drejtësisë, të së mirës, të bukurisë, të mikpritjes e të vëllazërimit.

Shtatë këshillat e Papës Françesku

“Nuk duhet të presim gjithçka nga ata, që na qeverisin, do të ishte fëmijërore – citon Ati i Shenjtë enciklikën e tij të fundit 'Fratelli tutti'. – Gëzojmë një hapësirë përgjegjësie të përbashkët për të nisur e vijuar procese e shndërtime të reja. Sot, jemi para një

rasti të jashtëzakonshëm për të shprehur faktin se jemi vëllezër, se jemi samaritanë të mirë, që marrin mbi vete dhimbjen e dështimeve, në vend që të nxisin urrejtje e hakmarrje”. Sot, na duhet aftësia për të krijuar harmoni, nënvizon Papa, para se të japë shtatë këshilla për mënyrën si duhet të impenjohemi të gjithë së bashku:

- “për të vënë në qendër të çdo procesi edukativ formal e jo formal njeriun, vlerën e dinjitetin e tij, për të nxjerrë në pah veçoritë e tij specifike, bukurinë, unicitetin e, njëkohësisht, edhe aftësinë e tij për t'u lidhur me të tjerët e me realitetin, që e rrethon, duke hedhur poshtë ato mënyra jetese, që favorizojnë përhapjen e kulturës së hedhurinave”.

- “Së dyti: të dëgjojmë zërin e fëmijëve, të adoleshentëve dhe të të rinjve, të cilëve t'u transmetojmë vlera e njohuri për të ndërtuar së bashku një të ardhme në drejtësi e paqe, një jetë të denjë për çdo njeri”.

- “Së treti: të favorizojmë pjesëmarrjen e plotë të vajzave dhe të të rejave në arsimim”.

- “Së katërti: ta shohim familjen si subjektin e parë e të domosdoshëm të edukimit”.

- “Së pesti: të edukojmë dhe të edukohemi që të mirëpresim, duke ua hapur zemrën më të brishtëve dhe më të mënjanuarve”.

- “Së gjashti: të ipenjohemi të studiojmë për të gjetur mënyra të tjera për ta kuptuar ekonominë, politikën, rritjen dhe zhvillimin, që të jenë me të vërtetë në shërbim të njeriut dhe të krejt familjes njerëzore, në perspektivën e ekologjisë së gjithanshme”.

- “Së shtati: të ruajmë dhe ta kultivojmë shtëpinë tonë të përbashkët, duke e mbrojtur nga shfrytëzimi i burimeve, duke ndjekur mënyra jetese më të thjeshta e duke përdorur plotësisht energji të rinovueshme, që respektojnë ambientin njerëzor e natyror, sipas parimeve të subsidiaritetit, të solidaritetit e të ekonomisë rrethqarkulluese”.

Edukim cilësor

Së fundi, Ati i Shenjtë kërkon impenjimin e çdo vendi për lindjen e një projekti edukativ, në të cilin të përdoren energjitë më të mira, në bashkëpunim me shoqërinë civile. Jep si pikë referimi doktrinën shoqërore të Kishës e nxit që të gjithë të mund të marrin një “edukim cilësor”. Papa Françesku është i bindur se edukimi përmban në vetevete farën e shpresës për paqe e drejtësi, për bukuri e mirësi; shpresën për harmoni shoqërore. E duke kujtuar se shndërrimet e mëdha bëhen nga të gjithë, sipas kompetencave, pa përjashtuar askënd, Ati i Shenjtë e përfundon videomesazhin me urimin që të gjithë të ecin përpara së bashku “drejt ndërtimit të një qytetërimi në harmoni e bashkim, ku të mos ketë vend për pandeminë e keqe të kulturës së hedhurivane”.

HYJI NA KA DHURUAR, KRIJIMIN!

*Me qeverisë” nuk do të thotë të bëjmë si të duam,
por të shikojmë të mirën dhe të përpiqemi me çdo mjet për ta arritur atë!*

Të dashur vëllezër e motra, e falënderojmë mirësinë e Hyjit që na lejon të fillojmë, me këtë kremtim, një vit të ri baritor, pas kohës verore që zakonisht i kushtohet pushimit e që, shpresoj, të na ketë sjellë të gjithë neve energji të ripërtërira për t'u angazhuar me më shumë entuziazëm në ecurinë që çdo bashkësi e krishterë është e thirrur për të ndërmarrë në këtë periudhë.

E po e bëjmë me një shikim kundruar mbi shtëpinë e përbashkët që Ati, Hyji na ka dhuruar, krijimin! Këtë vit kujtojmë 5 vjetorin e Enciklikës së papë Françeskut “Ti Qofsh lëvduar”, një dhuratë e madhe për Kishën, një dokument themelor që na lejon t'i hapim sytë mbi dhuratën që kemi marrë – krijesën - e që shumë shpesh nuk e vlerësojmë sa duhet, madje e keqtrajtojmë, me rrezikun që t'i bëjmë keq vetvetes dhe të tjerëve, duke na çuar në shkatërrim.

Tashmë, sa kohë në kishën katolike dhe në kishat e tjera motra, ajo ortodokse dhe protestante, është ndërmarrë kjo rrugë që Ati i shenjë ka dashur ta ratifikojë me këtë Enciklikë. Edhe ne, si Kishë e pranishme në Shqipëri, duam t'i bashkohemi këtij angazhimi me të gjitha fuqitë tona. Prandaj, ju ftoj të gjithë juve, meshtarë, rregulltarë e laikë, të merrni në dorë këtë dokument, ta meditonit dhe të nxirni përmbledhjet vepruese konkrete të cilat ta shohin angazhimin tonë për një ndryshim rrënjësor mentaliteti, për t'iu bindur në këtë mënyrë urdhrat të Hyjit krijues, atij për ta qeverisur tokën.

“Me qeverisë” nuk do të thotë të bëjmë si të duam, por të shikojmë të mirën dhe të përpiqemi me çdo mjet për ta arritur atë, duke u nisur nga stilet tona të jetës, të cilat gradualisht, por me angazhim serioz, duhet të ndryshojnë gjithnjë për më të mirën. Përvoja e emergjencës shëndetësore që po jetojmë për shkak të pandemisë së Covid-19, na mëson se çfarë është vërtetë e rëndësishme dhe çfarë jo. Por, a kemi me të vërtetë nevojë që natyra t'i kundërvihet njeriut, që të mund të kuptojmë rëndësinë e të bërit mirë vetes sonë duke i bërë mirë natyrës?

Leximet e këtij Kremtimi eukaristik janë të njëjtat që shpresoj të merren, së bashku me kremtim, nga të gjitha bashkësitë e Dioqezës, e të cilat j'ua kemi dërguar të gjithëve, e për rehati i kemi vënë në dispozicion në faqen e internetit dhe në social media të Dioqezës. Është rëndësi themelore që pas kësaj Meshe, të vazhdojmë me reflektua dhe me u lutë, duke lejuar që të

ndriqohemi nga Fjala e Hyjit.

Çfarë na thotë kjo Fjalë?

Në leximin e parë kemi dëgjuar një ftesë të fortë, një qortim ndaj ndokujt, që edhe duke besuar në Hyjin, nuk bën asgjë për t'u kthyer mbrapa nga sjellet e liga, duke përfutur nga mirësia e Hyjit që vazhdon t'i bëjë mirë botës nëpërmjet stinëve dhe fryteve të tokës.

Kemi dëgjuar në Ungjill fjalën ngushllimtare të Jezusit që, ndërsa pohon mirësinë e Hyjit kundrejt çdo njeriu, është njëkohësisht edhe një ftesë për të mos e shfrytëzuar natyrën, por për ta ngritur veten, duke kërkuar përkundraz mbretërinë e Hyjit: kjo do të jetë për ne garanci se përfitimet e tokës do të vazhdojnë të mos na mungojnë.

Kështu, edhe psalmi na garanton që, sapo të jemi kthyer duke u larguar nga e keqja, Hyji nuk do të lejojë që të na mungojë aq sa na nevojitet për jetesë.

Çfarë mund të mësojmë nga ky mësim biblik?

Jemi krijesa, pjesë e këtij krijimi që i është besuar përgjegjësisë sonë. Çfarëdo lloj forme shfrytëzimi i lig (përdorimi i planetit tonë më shumë sesa mund të na japë), manipulimi (shkuarja kundër ligjeve të natyrës), keqtrajtimi (ndyrësia, ndotja, djegia) është mëkat: është shkuarja kundër Hyjit që na ka bërë këtë dhuratë përgjegjësie, dhe ne e përdorim keq.

Në fakt është tamam ky përkufizimi i mëkatit sipas katekizmit të Kishës Katolike. “*Mëkatit është një mangësi kundër arsyes, të vërtetës, ndërgjegjes së shëndoshë; është një shkelje e rendit të dashurisë së vërtetë, kundrejt Hyjit dhe kundrejt të afërmit, për shkak të një lidhjeje të çoroditur me disa lloj të mirash. Ai e plagos natyrën e njeriut dhe e cenon solidaritetin njerëzor*” (n. 1846).

Të sot jemi në fillim të një rrugëtimi të ri, për t'i kërkuar falje Hyjit për çdo mëkat që kemi mundur të bëjmë kundër tij, të afërmit tonë dhe krijimit, që është shtëpia jonë e përbashkët. Të kërkojmë mëshirë e hir, që të dimë të shoshitim çfarë është e mirë dhe e drejtë për t'u bërë, kështu që koha jonë ta gjejë qetësinë, të stabilizohen rishtazi ekulibrat që kemi prishur, dhe ecja jonë drejt lirit të plotë nga korrupsioni na lejoftë që të hyjmë në “*lirinë e në lavdinë e bijve të Hyjit*” (Rom 8, 21).

Zoti na bekoftë të gjithëve dhe na liroftë nga çdo e keqe. Amen.

Homelia 01/09/2020
Mons. Angelo Massafra

JETA KISHTARE DHE E ARDHMJA E SAJ

*Këshilli i Konferencave Ipeshkvnore të Evropës
ASAMBLEJA PLENARE
Mesazhi final i ipeshkvijve*

26 shtator 2020



Në fund të Asamblesë Plenare, Ipeshkvijtë e Këshillit të Konferencave Ipeshkvnore të Evropës (KKIE) i drejtojnë një fjalë Kishës katolike, që jeton në Kontinent, të krishterëve të Konfesionëve të ndryshme, besimtarëve të çdo Feje, të gjithë qytetarëve evropianë.

E bëjmë me përlësi, duke e ditur se nuk kemi një mençuri tonën për të sjellë, por Fjalën që Hyji i ka thënë botës në Jezu Krishtin, i cili vdiq dhe u ngjall, në mënyrë që njerëzimi të kishte jetën e amshuar.

E bëjmë këtë gjë të nisur prej një ndjenje përgjegjësie si Barinj të Bashkësive, duke e ditur se priftërinjtë dhe besimtarët tanë bashkohen me ne, dhe të vetëdijshëm se Kisha duhet të jetë, sipas fjalës së Krishtit, kripë dhe tharm në histori.

Për këtë kohë Asambleja është lutur, ka reflektuar jo vetëm për të regjistruar atë që ndodh me pandeminë dhe pasojat e saj në jetën e secilit, në punë, në shoqëri, në familje, në marrëdhëniet midis Shteteve dhe Kontinenteve, në jetën kishtare, por edhe për të ardhmen.

Në lidhje me këtë, nuk ofrojmë zgjidhje praktike si është detyra e atyre që kanë përgjegjësi publike, por është pjesë e detyrës

sonë baritore që t'i kujtojmë ndërgjegjes personale dhe kolektive disa qëndrime të një rendi shpirtëror dhe etik. Në fakt, ndërtesa e qytetërimit modern duhet të bazohet në parime shpirtërore, të afta jo vetëm për ta mbajtur, por edhe për ta ndriçuar dhe për ta gjallëruar atë.

Para së gjithash, një besim i rizbuluar. Pa këtë mënyrë të të qenit nuk mund ta shikojmë të nesërmen. Arsyeja e besimit tonë si besimtarë është Krishti, që u bë njeri dhe, përmes vdekjes, e shpërbleu jetën. Çdo ditë Krishti është i pranishëm mes nesh në Eukaristi, burimi i besimit dhe i zellit tonë apostolik e misionar, që na fton të dalim, të shkojmë tek të gjithë. Mungesa e Eukaristisë në të kaluarën është një thirrje për t'u kthyer në bashkësinë e plotë në asamblenë e sotme liturgjike. Për të gjithë, arsyeja e besimit qëndron në zemër: thellë brenda saj jeton një dëshirë themelore, ajo e di se nuk mund të jetohet në dyshim dhe mosbesim, por në besimin ndaj të tjerëve dhe ndaj jetës.

Së dyti, një solidaritet i ripërtërirë midis personave, popujve dhe Kombeve, edhe në krizën serioze të punësimit. Zoti Jezus është solidariteti i Hyjit. Përvoja universale tregon se çdo qenie njerëzore ka nevojë për të tjerët, se

askush nuk është i vetëmjaftueshëm: mjafton një virus i padukshëm për të thyer iluzionin e të qenit “i pathyeshëm”. Mirënjohja jonë shkon për mjekët, punonjësit e shëndetësisë, forcat e rendit dhe vullnetarët, të cilët, duke ndjekur shembullin e Krishtit, kanë mbështetur popullatat në vështirësi, veçanërisht ato më të dobëtat. Nëse marrëdhënia është pjesë e natyrës sonë, atëherë çdo mbyllje ndaj të tjerëve për të mbrojtur vetveten, çdo interes individual, deri në përfitimin nga fatkeqësitë, është kundër dinjitetit personal, kundër kolektivitetit: është kundër të drejtave të njeriut. Askush nuk duhet të përjashtohet, edhe në shpërndarjen e vaksinës. Përballë dramës së kaq shumë refugjatëve dhe migrantëve, është e nevojshme që të punojmë së bashku dhe të vazhdojmë të dialogojmë me qeveritarët për të mbrojtur jetën dhe dinjitetin e çdo personi. E bëjmë këtë thirrje në prag të Ditës Botërore për Migrantët dhe Refugjatët.

Kërkimi i rrugëve solidare për t'i përballuar vështirësitë, ashtu si edhe për të ruajtur dhe për të rifilluar normalitetin e jetës, shpreh vetëdijen e të qenit krah për krah në të njëjtin fat dhe kërkon forma konkrete të shprehjes, edhe ndaj krijimit, për të cilën jemi të thirrur që të kemi një kujdes të përtërirë, sepse është vepra e Hyjit, dhënë neve si shtëpi e përbashkët.

E dimë se Kontinenti po e ndjek këtë rrugë dhe ne Ipeshkvijtë inkurajojmë çdo përpjekje për të qenë në lartësinë e detyrës, duke kujtuar përgjegjësinë e tij ndaj botës që buron nga humanizmi i krishterë në zanafillë të historisë së tij. Kisha është e pranishme dhe ka ofruar çdo formë afërsie dhe ndërhyrjeje. Ajo do të jetë gjithmonë besnike ndaj mandatit të Zotit. Në këtë horizont, shpresojmë për një zgjidhje paqësore në Bjellorusi, që ka si bazë dialogun dhe pajtimin. Po ashtu, jemi afër popullit të Libanit, thellësisht të plagosur nga ngjarjet e fundit.

Duam t'u shprehim admirimin dhe dashurinë tonë bashkësive tona për përgjigjen e shpejtë në këtë situatë krize dhe i nxisim ato që të kenë besim: shpesh kanë punuar së bashku me konfesionet e tjera të krishtera dhe me fetë e tjera. Edhe rifillimi i jetës së besimtarëve do të kërkojë gjithashtu durim dhe këmbëngulje. Zoti Jezus punon në zemrat tona, i largon frikat dhe na tërheq me dashurinë e tij. Nëse do të ketë situata të reja për t'i përballuar, ndoshta vështirësi të papritura, nuk duhet të kemi frikë. Neve na takon të jemi nxënës besnikë të Zotit.

Për ju dhe për Evropën e dashur të Popujve, përsëendetja tonë plot simpati, dashuri dhe lutje.



KRIJIMI ËSHTË NJË DHURATË E HYJIT PËR NJERËZIMIN

**Deklaratë e përbashkët e Presidentëve të CCEE-së dhe të CEC-it
me rastin e Kohës së Krijimit 2020**

Të krishterët e gjithë botës prej datës 1 shtator deri me datën 4 tetor kremtojnë Kohën e Krijimit dhe më 1 shtator kremtojnë Ditën e Krijimit. Edhe këtë vit, si vitet e kaluara, CCEE-ja dhe CEC-i përfitojnë prej këtij rasti që t'i nxisin besimtarët të Kishave në Evropë për t'i parë këto ditë si një rast për të kremtuar pasurinë e fesë sonë.

Koha e Krijimit zë fill që prej rrënjëve të fesë së krishterë. Krijimi është një dhuratë e Hyjit për njerëzimin dhe për të gjitha qeniet e gjalla, pra është përgjegjësia jonë që ta ruajmë atë si mbarështues të mirë e të besueshëm dhe si shërbëtorë besnikë të Hyjit. *“E Zotit është toka dhe gjithçka ajo ka, rruzulli mbarë e të gjithë banorët e tij”* (Ps 24, 1).

Papa Francesco në enciklikën e tij *Laudato Si' (Ti Qofsh Lëvduar)*, ka theksuar se *“sfida urgjente për ta mbrojtur shtëpinë tonë të përbashkët përfshin shqetësimin për ta bashkuar krejt familjen njerëzore në kërkim të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe tërësor”*. Në të njëjtën kohë, ka bërë një apel të fortë *“për ta ripërtërirë dialogun mbi mënyrën me të cilën jemi duke e ndërtuar të ardhmen e planetit tonë. Kemi nevojë për një ballafaqim që na bashkon të gjithëve, pasi sfida mjedisore që jetojmë dhe rrënjët e saj njerëzore, kanë lidhje me ne dhe na prekin të gjithëve”*.

Në të njëjtën mënyrë njëri prej teologëve më të mëdhenj të epokës sonë, Juergen Moltmann, ka deklaruar se *“sot kundërshtari teologjik është nikilizmi i praktikuar në marrëdhëniet tona me natyrën”* dhe ka kërkuar *“një shoshitje mbi Hyjin që është i pranishëm në krijim nëpërmjet Shpirtit Shenjt të Tij”*, një shoshitje që *“mund t'i çojë burrat dhe gratë në pajtim dhe paqe me natyrën”*.

Kremtimi i Ditës së Krijimit dhe Koha e Krijimit ka një përmasë ekumenike domethënëse. Duke kremtuar këto ditë le të shikojmë prapa në shenjë falënderimi ndaj propozimit të të ndjerit Patriark ekumenik Dimitrios I bërë në vitin 1989. Që atëherë, ideja e Kohës së Krijimit dhe shpirti i tij ekumenik janë

konfirmuar edhe më shumë në Asambletë Ekumenike Evropiane të organizuara së bashku prej CCEE-së dhe CEC-së, prej Bazilësë (1989) nëpërmjet Gracit (1997) deri në Sibiu (2007).

Këtë vit, pandemia COVID-19 ka zbuluar se sa thellësisht e ndërlidhur është bota në të cilën jetojmë. Më shumë se kurrë kemi kuptuar se nuk jemi ishuj për njëri-tjetrin dhe se kushtet për shëndetin e mirëqenien njerëzore janë të brishta. Ndikimet e pandemisë na detyrojnë që ta marrim seriozisht nevojën për një vigjilencë më të madhe dhe për kushte jete të qëndrueshme në mbarë tokën. Kjo gjë bëhet edhe më e rëndësishme nëse marrim parasysh shkatërrimin mjedisor dhe kërcënimin e ndryshimit klimatik.

Ju ftojme që ta kremtoni këtë vit Kohën e Krijimit nën titullin e Jubileut për tokën. Koncepti i Jubileut është i rrënjësuar në Bibël dhe thekson se duhet të ekzistojë një ekuilibër i drejtë dhe i qëndrueshëm mes realitetit shoqëror, atij ekonomik dhe ekologjik. Mësimi i jubileut biblik na tregon nevojën për t'i riekulibruar sistemet e jetës, pohon nevojën e barazisë, të drejtësisë dhe të qëndrueshmërisë, pohon gjithashtu nevojën për një zë profetik në mbrojtje të shtëpisë së njeriut.

I ftojme të gjithë Barinjtë dhe të krishterët evropianë, famullitë, bashkësitë kishtarë dhe çdo person vullnetmirë, që t'i kushtojnë vëmendje Kohës së Krijimit për ta jetuar atë me shpirt ekumenik, të bashkuar në lutje dhe veprim.

**I Nderuari Christian Krieger
President i CEC-it**

**Hirësia e Tij Kard. Angelo Bagnasco
President i CCEE-së**



DON NOSH GJOLAJ

CIKLI I NATËS DHE AI I DITËS DUHET TË RESPEKTOHET

(Pjesa e dytë)

Oshtimat, fëshfërimat apo gërhitjet e natës gjatë gjumit duhen të zgjedhën

Çka i përket individit, apo partnerit, i cili është i ndjeshëm ndaj oshtimës, fëshfërimave posaçërisht gërhitjes ose folmja në zë gjatë gjumit i shkakton jo vetëm pengesa e llojllojshme por edhe ia çrregullon pushimin ose fjetjen. Në rastet do të ishte ideale duke ju këshilluar partnerëve, që t'i kenë dy dhoma fjetje, ashtu çdo njëri e ka qetësin e vet. Por kjo nuk është e mundur dhe objektive në rastet e shumta, që partnerët jetojnë. Si për shembull, partnerët jetonin dhe banonin në gjirin e familjes së gjerë, ose nuk ka mundësi për të pasur komodi tetin në fjalë, atëherë është e arsyeshëm që të kërkohej banesa e re. Por edhe në këtë rast kushtet materiale apo ekonomike nuk ju mundëson. Nuk duhet harruar edhe ndikimi i mjedisit, veçanti te populli shqiptar është bile çifti martesor viktimë, e thashethemet, duke filluar nga vjehërria, e cila do të shqetësohet shumë për çiftin e ri, se çka i gjeti, ajo zakonisht mendon në vete, se çifti në fjalë është në krizë, e dashuria e tyre ka filluar të zbehet e sipas saj gjendet apo ballafaqohet me vështirësitë e pakapërcyeshme e nuk u mbetet tjetër përveç shkatërrimi i kësaj dashurisë! Vjehrra në fjalë do të fillojë të flasë duke varur në kambanat e mëdha gjestin e çiftit të ri (dy dhoma fjetje). Nusja e re filloi ta sundoi e ta marrin nëpër këmbë djalin e saj! Sepse ajo nuk e kupton as nuk mund ta kuptojnë se çifti i ri kërkon në marrëveshje njëri me tjetrin e kanë nda banesën, për ta zgjedhur problemin e zhurmës, gërhitjes, se njëri prej partnereve gjatë natës në gjumë flet në zë, apo gurgullimet e gjumit, që i pengon partnerit, i cili është jo vetëm i ndjeshëm por edhe mbet pagjumë! Por nëna e djalit shqetësohet për së teprimit se çka e gjeti djalin e saj, ku u takojë pikërisht atyre kjo e zezë: "Prej asaj ditës që ka ardhur kjo shtrig në shtëpinë tonë, ia piu mendjen e kresë, e djali ynë thajse nuk është më ai i dikurshëm, ai tani ka ndërruar krejtësisht, ai është tjetërsuar, nuk është më ai djali i ynë i dëgjueshëm, i mirë, i sjellshëm, por tani sjellët si i dehur, mos vallë dikush i ka bërë ndonjë magji! Ç'u bërë me të?" Në mënyrë paniku dhe hysterike vjehrra zakonisht sjellët. Ndoshta shkon edhe deri te prifti, te hoxha, ose te shortaret për ta shikuar kripen, për ta kërkuar ilačin për ta shëruar djalin e dashur, të

cilin dikush i ka bërë magji. Ajo nuk kursen asgjë vetëm për ta gjetur ilačin, bile beson çdo marrisë që i thotë dikush edhe do ta sprovonë për ta realizuar!!!

Në të kundërtën do të ishte një lëshim fatal, po qe se çifti i ri bie nën diktatin e rrethi apo të mjedisit, dhe bëhet viktimë i thashethemave, të cilët nuk janë më zotët e vetes por do ta krijojnë identitetin në thashethemet e mjedisit. Se çka dhe kush mendon për çiftin e ri, është absolutisht e pa rëndësishme, po ashtu nuk ka fare rëndësi apo peshë se çka do të mendojë edhe nëna apo prindërit pikërisht në këtë rast e vjehrra ose i vjehrrë. Kuptohet se në këtë rast: as e vjehrra as vjehërrë e as mjedisi nuk mendon mirë as nuk kontribuon për mirën e tyre (çiftit) në fjalë. Sjellja paniku hysterik, prej ngarkesat e thashethemeve, paragjykimet, frustrimet fillojnë zakonisht pran kafes, aty nuk do të mungojnë nga mjedisi as imagjinatat e imagjinuara, që nuk janë asgjë tjetër përveç dëshirat e parealizuar nga ana prindërit, të cilët e shohin djalin apo vajzën si dorë e zgjatur për ta realizuar veten. Po qe se dikush ia rrëmben këtë dorë, atëherë kuptohet manifestimi hysterik i paniku dhe shqetësimet e tilla që janë jo reale. Por çifti i ri duhet ta kuptojnë rolin e prindit, që nuk është asgjë tjetër përveç rivalitetit në strukturën e familjes, që do të jetë tema veçantë mbi këtë problematik, por e rëndësishme është raporti i çiftit për të ndalur nga rrethi magjik me një farë natyrshmërie, në mënyrë spontane pa ndonjë dhembje të madhe, duke e përgatitur përpara terrenin, kuptohet nga ana e çiftit jo vetëm mençuri por edhe shkathtësi e diplomacisë. Dashuria duhet të diktojë stilin e jetës, të cilën duhet dita-ditës të fisnikërohet, të begatohet, të kultivohet dhe mos të bastardohet apo të çoroditet për shkak të një qesharakes së përditshme, qoftë ajo vjen nga mjedisi apo nga gjiri familjar!

"Manie e gjumit apo e fjetjes"

Çiftin martesor e ngarkon apo e çrregullon harmoninë e përbashkët ashtu e quajtur ndër tjera edhe "mania e fjetjes", që nuk është asgjë tjetër përveç një farë sëmundje e tepruar për fjetje ose veti apo shprehje e tepruara për gjumë apo fjetje, e cila nuk është e shëndoshë as normale, sepse njeriu si individ nuk ka kurrfarë nevojë psikologjike për një

fjetje të tepruar, por ajo e ngarkon apo e çrregullon jetën e përbashkët duke krijuar pakënaqësi dhe murmurime.

Në jetën e përditshme mund të tolerohet fjetja apo gjumin e zgjatur vetëm ata individ, të cilët janë të sëmurë, po ashtu edhe pleqve, eventualisht vlen edhe për njerëzit të profesioneve të lira, ose aty ku partnerët janë pa punë. Individit, i cili e shfrytëzon çdo minutë apo çdo çast që i jepet për të fjetur, ai si i tillë jo vetëm se është i pakujdesshëm por i mungon principi ose pikëpamjet konstruktive të jetës. Ai ende nuk është i bindur as nuk është vetëdijesuar se jeta e njeriut biologjike apo fizike është mjaft e shkurtër. Detyra e çdo njeriut është për ta realizuar vetveten, kuptohet nëpër mes profesioni, por deri te profesioni po ashtu kërkohet shumë orvatje, mund, djersë, që nuk është asgjë tjetër përveç formimi i shëndosh i identitetit. Vetëm njerëzit e tillë me shprehje pune janë krijues, kontribuojnë jo vetëm për vete por edhe për rrethin më të gjerë, për kombin e për qarqet ndërkombëtare. Ata e shfrytëzojnë çdo moment për të krijuar, siç fjala bie, njerëzit e tillë edhe i stolisin me ndonjë çmim nobel apo diçka

tjetër. Vetëdijesimi i plotë ja mundëson individit për t'ia dhënë punës qëllimin e arsyeje. Puna nuk e krijon njeriun siç pohonte ideologjia komuniste, por njeriu e krijon punën për t'u realizuar jo vetëm ai si person por edhe për ta realizuar programin e Hyjit, duke e fisnikëruar botën, duke ngritur civilizimin, teknike etj. Menje fjalë, njeriu është partner i Hyjit për realizmin e Mbretërisë së qiellit.

Ata të cilët nuk e realizojnë vetveten, zakonisht në moshën e pleqërisë janë mjaft të tërhequr, murmuritësh, të pa kënaqur, vetëm fajësojnë tjetrin për mos realizimin e vetes. Me një fjalë janë pleqtë të rënd dhe të padurueshëm që nuk janë asgjë tjetër përveç barrë apo ngarkesë e familjes, me sjelljet e tyre të bezdisshme. Në të kundërtën njerëzit të cilët e realizojnë veten, ata janë pleqtë mjaft aktiv, të përshtatshëm, të gëzueshëm, të lezetshëm, konstruktiv e në fund as nuk i frikohen vdekjes, përderisa ata që nuk e realizojnë veten jo vetëm se janë frikacak ndaj vdekjes por mjaft egoist plot vete që kërkojnë gjithherë praninë e kujdesin e tjetrit që të jetë në vëmendje!

Çfarëdo punën që e bënë njeriu duhet ta bëjë



me zemër duke u mishëruar në atë punë, sa do është puna e rënd apo e lehtë edhe e bëri me zemër, puna e tillë e përtëri, e freskon po ashtu e frymëzon, në të kundërtën sa do e lehtë është puna që e kryen, jo vetëm se e plakë por ia thithë energjinë, ia humbë vullnetin e jetës. Me tjera fjalë gjithëherë është mirë që çifti të vetëdijesohet e po ashtu edhe të motivohet për punë. Kuptohet vetvetiu se pushimi e gjumi janë të domosdoshme për t'u furnizuar me energjitë e reja, por në kufijtë e normales. Siç e kemi theksuar më lartë për individin punëtorë i mjaft shtatë deri tetë (7-8) orë fjetje. Çka është më shumë është humbje kohe, mos të themi kohën e çmuar që nuk ripërtërihet apo nuk_kthehet më mbrapa. Po qe se personi nga natyra është tip i papërcaktuar e në anë tjetër ia bërë shprehi gjumi i zgjatur, këtë mund ta përmirësoi po qe se ka një vullnet të fortë e njëherë të motivohet për realizimin e vetes. Ashtu ai mund lehtë ta ndërroi pikëpamjet e gabuara ndaj jetës dhe t'i përqafojnë mendësinë e shëndoshë, e cila do t'i sjellin jo vetëm kënaqësi, freski, krijimtari por edhe harmoni në bashkësinë martesore. Është mjaft me rëndësi, që të theksohet identiteti, formimi i shëndoshë të qëndrimeve ndaj jetës, ose pikëpamjeve filozofike ndaj saj. Po ashtu kujdesi i përhershëm që nuk është asgjë tjetër përveç preventiva për ta penguar si dromin e pagjumësisë e skajin tjetër të saj gjumësia e zgjatur. Si njëra ashtu edhe tjetra shumë lehtë jo vetëm se e ngarkojnë jetën e përbashkët por shpeshherë janë edhe shakatarët e fundosjes së vaporit martesor. Si pagjumësia ashtu edhe “mania e fjetjes”, individin si të tillë e shkatërron e bënë invalid, gjysmak mos të themi nganjëherë edhe të çoroditur. Po qe se tolerohen gabimet e tilla në gjirin martesor siç është fjala gjumin e zgjatur, shumë shpejt edhe do tu hakmerret, këtë apo në tjetrën mënyrë. Duhet të luftohet bindjen e gabuar, që shumica të rinjve mendojnë se jeta martesore është ideal po qe se kalohet shumë kohë në krevat!

Ja disa këshilla praktik për bashkëshortit e ri:

Preferohet për një harmoni normale dhe të natyrshme në mes partnerëve, që kërkon një pushime të mira si të fjetjes ashtu edhe relaksim psikik e fizikisht dhe shpirtëror. Për t'ia arrit këtë qëllimin, preferohet që partnerët ta kenë dhomën e fjetjes të përbashkët dhe të ndamë nga dhomat tjera, e cila duhet të jetë e mobiluar mirë dhe mundësisht e izoluar nga zhurma e trafikut, apo ndonjë zhurmë apo murmurimë tjetër, që mund lehtë të tërheqin vëmendjen e bashkëshortëve. Po ashtu në disa raste të dyshimi, të mos u mundësohet tjerëve të përgjohen nga anëtarët e familjes së gjerë, sepse në këtë rast jo vetëm se ngarkohet çifti në fjalë por

shkakton pakënaqësi, humbja e ritmit të gjumit e mos të flasim për ftohtësinë e pasionit apo impulsit seksual dhe mos realizimi i plotë i kënaqësive trupore e shpirtërore, që frenohet nga mendimin mos vallë se dikush të përgjon.

Si është e dëmshëm gjumi i tepruar ashtu është edhe puna e tepruar, si fjala vjen, për njerëzit me natyrë shumë aktive. Ata zakonisht jo se nuk kanë kohë të mjaftueshëm për të pushuar apo fjetur por nuk kanë kohë as për shkëmbimin e dashurisë, që shkakton mos kënaqësi në marrëdhënie e shtratit, ftohje, impotencë, që i shoqëron edhe mendësia materialiste, vetëm për të pasur para, e në të kundërtën ata ia çelin vetes varrin apo gropën që e gropojnë dashurinë, fisnikërinë e harmonin e jetës. Zakonisht tipat që punojnë për së teprimit, jo vetëm se janë të shterur fizikisht por janë të lodhur shpirtërisht e psikik dhe të paafte për shkëmbimin krijues edhe në raportet e barabarta e ndërsjellat të sferës së dashurisë. Jeta seksuale në këtë rast nuk është asgjë tjetër përveç instrument apo objekt për t'u shfryrë impulsin e saj!

Po ashtu u preferohet bashkëshortët për një disiplinë apo një regjim të shëndoshë me një fjalë një orar si për pushim ashtu edhe për fjetje apo gjumë të qetë. Gjatë pushimit njeriu çlodhet muskulatura apo organizmi i tendosur dhe me relaksimet e rifiton energjinë e humbur. Jo vetëm se është e dobishme por edhe e preferuese dalja në ajarin e pastër prej 10-15 minuta përpara gjumit. Ndërsa darka nuk duhet të jetë e rënd por preferohet që të jetë e lehtë dhe modeste e jo orët e vona të natës. Po ashtu ka rëndësi edhe dëfrimi apo argëtimi i larmishëm, që jo vetëm se çlodhë personin por edhe e mbushë plot freski, gjallëri, krijon emocionet e fat lumturisë, dispozitën e hareshme shpirtërore. Për këtë është mirë gjithëherë çifti të shërbehet me ndonjë humor të shëndoshë e gazmor. Këto metoda jo vetëm se u ndihmon t'i kapërcejnë ngarkesat e ditës por i shmangen ankthit, stresit depresionit, që ndikojnë shumë në jetën e përbashkët të dashurisë. Gjithashtu mos të nënçmohet sporti, dalja në natyrë, gjimnastika, aktivitet fizike, siç është kopshti, ujitja e luleve etj. jo vetëm se çifti mbet vital dhe i freskët por kursehet nga dhjamosja e tepruar si dhe nga pesha e tepruar e trupit, që ndikon po ashtu në uljen e potencës seksuale. Filozofi i njohur, Aristoteli thotë: njeriun e shkatërron jo lodhja fizike apo psike por papunësia apo pasiviteti i tij fizik. Po e njëjta gjë vlen edhe për gjumin e tepruar, njeriun jo vetëm se e shter por edhe e paafte për jetën kreative e në anën tjetër do ta shoqëroi pasiguria seksuale, stres, ankthi dhe depresioni!

M. MARJETA GJOKA

KRIJUESI, KRIJIMI, KRIJESA

“Sa të shumta janë, o Zot, veprat e tua! Të gjitha i ke bërë me urti të madhe, [...]” (Ps 104, 24).



Në këtë kohë lutjeje ishte shumë e rëndësishme që të ndalemi e të reflektojmë mbi krijimin, një temë që kohët e fundit falë Papa Françeskut është prekur shumë dhe ka pasur një vëmendje të veçantë. Ka qenë vërtetë e nevojshme që të bëjmë një retrospektivë dhe ti japim rëndësinë e duhur çdo gjëje të krijuar nga vetë Krijuesi, duke evituar prirjen e qenjes njerëzore e cila dëshiron të jetë zotëruese e krijimit dhe jo bashkëpunuese me projektin e Hyjit. Ajo që ne na intereson mbi të gjitha, është që të specifikojmë lidhjen e ngushtë dhe relacionale mes Hyjit, krijimit dhe njeriut. Është e pa mundur ti ndajmë këta tre ralitete nga njëri - tjetri. Si gjithmonë themeli i çdo argumenti është Shkrimi Shenjtë nga ku buron çdo gjë. Libri i Zanafilles na përcjell se si Hyji e krijoj universin dhe qënjen njerëzore, (Krh. Zan 1, 1–27).

Me krijim nënkuptojmë gjithçka që ekziston në univers, të gjitha kategoritë e ndryshme të qenieve të gjalla kafshët, bimë të gjitha llojet, çdo element natyror pafundësisht i madh dhe pafundësisht i vogël. Krijimi është gjithçka që na rrethon është vendi ku lind njeriu dhe jeta, është *habitati* i tij, shtëpia e tij natyrore, ku jemi të ftuar të kemi kujdes të veçantë për mirëmbajtjen e tij. Edhe Papa Françesku në letrën Enciklike duke rimarrë këngën e Shën Françeskut «*O Zoti im ti qofsh lëvduar*», shprehet se: «Shtëpia jonë e përbashkët është gjithashtu si një motër, me të cilën ne ndajmë jetën, është si një nënë e bukur që na pret në krahët e saj», (*Letra enciklike*, Papa Françesku *Laudato si*, nr. 1).

Duke studiuar më thellë domethënien e krijimit, vërejmë se në fjalorin hebraik – të krishterë nuk flitet për “natyrë” por flitet për “krijim”, që ka një ndryshim thelbësor mes tyre, sepse termi krijim bën të kuptojë se i gjithë universi e ka origjinën nga akti krijues i Hyjit: dhe në të vërtetë është krijesë dhe jo thjesht natyrë. Edhe Katekizmi i Kishës Katolike na bën të kuptojmë që bota nuk është vetëm thjesht produkt i çfarëdoje i një fati të verbër, bota buron nga vullneti i lirë i Hyjit. (Krh. *Katekizmi i Kishës Katolike* nr. 295). Ndërsa Papa Benedikti XVI pohon, që fjala “Krijim” përdoret, «sepse pema e madhe dhe e mrekullueshme e jetës nuk është rezultat i një evolucioni të verbër dhe irracional, por ky evolucion pasqyron vullnetin krijues të Krijuesit dhe bukurinë e Tij e mirësinë», (Krh. *Fjalim 28 nëntor*, 2011).

Papa Françesku kështu e motivon atë: «duke thënë se krijimi është më shumë sesa të thuhet natyrë sepse ka të bëjë me një projekt të dashurisë së Zotit, ku çdo krijesë ka një vlerë dhe një kuptim. Natyra shpesh kuptohet si një sistem që analizohet, kuptohet dhe menaxhohet, por krijimi mund të kuptohet vetëm si një dhuratë që buron nga dora e hapur e Atit të gjithësisë, si një realitet i ndriçuar nga dashuria që na thërret në një bashkim universal», (*Laudato si*, nr. 76). Siç e kam theksuar edhe më sipër rrënjët e kësaj teme i kemi në Shkrimin Shenjtë, duke u nisur nga aty na intereson të dimë cili është vizioni biblik i krijimit? Qasja Biblike e vë Hyjin në vend të parë si krijues, njeriun si krijesën e parë dhe krijimin si një

dhuratë të Hyjit për njeriun. Tregon ecjen së bashku të njeriut dhe mjedisit drejt Hyjit, në mënyrë që në krijim njeriu, çdo njeri, i gjithë njeriu të mund të zhvillohet dhe ta bëjë vetë krijimin të zhvillohet në të gjithë komponentet e tij, njerëz, kafshë, bimë etj.

«Në fillim Zoti krijoi qiellin dhe tokën [...] dhe pa që ajo ishte e mirë» (Krh. Zan 1, 1), janë fjalët me të cilat urtësia biblike na fton të shohim të gjithë realitetin e krijuar me sy objektivë dhe t'i japim lavdi dhe hir Krijuesit: «Sa të shumta janë, o Zot, veprat e tua! Të gjitha i ke bërë me urti të madhe: plot është toka me krijesat e tua» (Ps 104, 24). Pasi krijoi njeriun: «Hyji shikoi gjithçka kishte bërë dhe, ja, ishin shumë të mira!» (Zan 1, 31).

Ndërsa personin njerëzorë, mashkull dhe femër i vendosi në qendër të krijimit, dhe u tha:

«Shtohuni dhe shumohuni e mbusheni token dhe sundojeni atë! Bëhuni zotëruesit e peshqëve të detit, të shpendëve të qiellit dhe të çdo gjallesë që lëviz përmbi tokë!» (Zan 1, 28).

Vetëm personi i nënshtrohet gjithë krijimit, gjithçka vendoset në shërbim të një realizimi progresiv dhe të plotë të njeriut, natyra është në shërbim të njerëzve. Por në të njëjtën kohë njeriu nuk duhet të abuzojë, por ta përdorë atë me përkujdes dhe me një moderim të matur duke e kultivuar atë, (Krh. *Përmbledhje e doktrinës të kishës*, nr. 258).

Pikërisht të kultivosh do të thotë të plugosh ose të punosh një tokë, ta ruash atë, do të thotë ta mbrosh, të kujdesësh, ta mbikëqyrësh. Me këtë nënkuptojmë një marrëdhënie reciprociteti të përgjegjshëm midis qenies njerëzore dhe natyrës, (Krh. *Laudato si*, nr. 67).

Në fillim ishte një marrëdhënie e mirë midis krijimit dhe njeriut, e ndërprerë më pas nga mëkati. Ishte mëkati origjinal ai që bëri të hyjë çrregullimin në natyrë, në marrëdhëniet midis njeriut dhe natyrës (Krh. Zan 3, 17 - 19). Edhe enciklika *Laudato si* na flet për njeriun e pamëshirshëm ndaj njeriut dhe mizoria e njeriut ndaj krijimit, dhe mëkati personal i gjithë neve që jemi pasardhës të të parëve tanë, shton shumë çrregullim. Ekzistenca njerëzore varet nga tre marrëdhënie themelore të lidhura ngushtë, marrëdhënia me Hyjin, ajo me të afërmin dhe ajo me tokën. Sipas Shkrimit Shenjtë këta tre relacione jetësore janë thyer, jo vetëm jashtë por edhe brenda nesh. Kjo thyerje është mëkati, harmonia midis Krijuesit, njerëzimit dhe të gjithë krijimit, është shkatërruar sepse pretenduam të zëmë vendin e Hyjit, duke refuzuar ta njohim vetveten si krijesa të kufizuara (Krh. Pap Françesku, *Laudato si*, nr. 66).

Në librin e Zbulesës shkruhet se ata presin: «një qiell të ri dhe një tokë të re, sepse qielli i parë dhe toka e parë u zhdukën» (Zb. 21, 1).

Këto fjalë të Zbulesës na kujtojnë kufirin e tërë

krijimit, ndërsa letra e Romakëve na thotë se: «E njëmend, edhe vetë krijesa me afsh e pret zbulimin e bijve të Hyjit: Krijesa, në të vërtetë, është e nënshtroar kotësisë - jo pse do, por për arsye të atij që e nënshtroi – porse njëmend në shpresë. Sepse, edhe vetë krijesa do të lirohet nga skllavërimi i shkatërrimit për të pasur pjesë në lirinë dhe lumturinë e bijve të Hyjit. Sepse e dimë: mbarë krijesa gjëmon dhe vuan në dhimbjet e lindjes deri tani» (Rom 8, 19 -22). Duke ditur që vuajtjet e tanishme nuk janë të krahasueshme me Lumturinë e ardhshme që duhet të zbulohet në ne, (Krh. Rom. 8, 18). Por e vërteta biblike na thotë se: «Ne veç, sipas premtimit të tij, presim *qiellin e ri e tokën e re*» (2 Pj 3, 13), gjithashtu thekson se gjithçka ka një kuptim dhe që i gjithë universi do të hyjë në plotësinë përfundimtare. Ky rinovim misterioz që do të transformojë njerëzimin dhe botën nga Shkrimi Shenjtë është përcaktuar kështu: «Kur të plotësohej koha: d.m.th. të vërë çdo gjë nën kryesinë e Krishtit, të gjithë qenësit që janë në qiell e në tokë» (Ef. 1, 10). Dhe ne jetojmë në vetëdijen që duhet të kontribuojmë në përgatitjen e, «*qiellit të ri e tokës së re*».

Nuk mund të propozohet një relacion me mjedisin pa marrë parasysh relacionin me njerëzit dhe me Hyjin.

Marrëdhënia e njeriut me botën ka lindur si fryt i marrëdhënies së thellë mes njeriut dhe Hyjit, sepse Hyji e ka dashur njeriun si bashkëbiseduesin e Tij. Vetëm në dialog me Hyjin krijesa njerëzore gjen të vërtetën e vet, nga i cili ai merr frymëzim dhe rregulla për të planifikuar të ardhmen e botës, një kopsht që Hyji i ka dhënë që ai ta kultivojë dhe ta ruaj (Krh. Zan 2, 15). As mëkati nuk e eliminon atë detyrë, edhe pse ngarkohet me dhimbje dhe vuajtje fisnikëria e punës së njeriut. Ekziston një reciprocitet i madh midis nesh dhe të afërmit tonë, krijimit dhe Hyjit, shprehet Papa Benedikti XVI duke thënë: «duke u kujdesur për krijimin ne vërejmë se Zoti përmes krijimit kujdeset për ne», (*Dita Botërore e Pages, 1^o Janar*, 2010).

Duhet të zbulohet se çfarë është kundër njeriut dhe krijimit, është gjithashtu kundër Hyjit sepse Hyjit është mbrojtësi dhe garantuesi i njeriut dhe i botës së tij. «[...] bota, jeta, vdekja, e tashmja, e ardhmja! Gjithçka është e juaja, ju jeni të Krishtit e Krishti është i Hyjit» (1 Kor 3, 22 - 23).

Shkrimi Shenjtë na garanton që njeriu është krijuar në përngjasimin e Hyjit, dhe në të njëjtën kohë njeriu është në qendër dhe në mbarimin e gjithë krijimit, (Krh. Zan 1, 26 - 27).

Hyji i flet njeriut nëpërmjet krijimit të dukshëm. Universi material i paraqitet inteligjencës së njeriut në mënyrë që ai të lexojë gjurmët e Krijuesit të tij.

Drita edhe nata, era edhe zjarri, uji edhe toka, pemët edhe frytet na flasin për Hyjin, na simbolizojnë në të njëjtën kohë madhësitin e Tij dhe afërmitetin e Tij. Siç vihet re krijesës, këto realitete të ndjeshme i bëhen vendi ku Hyji manifestohet. Pa harruar edhe veprimin e Hyjit që shenjtëron njerëzit, dhe veprimi i njerëzve që adhurojnë Hyjin.

E njëjta gjë ndodh me shenjat dhe simbolet e jetës shoqërore të njerëzve, larja dhe vajosja, thyerja e bukës dhe ndarja e kelkut mund të shprehin praninë shenjtëruese të Hyjit dhe mirënjohjen e njeriut ndaj Krijuesit të tij. Besimet e mëdha të njerëzimit dëshmojnë shpesh në një mënyrë mbresëlënëse ndjenjat ndaj krijimit. Liturgjia e Kishës presupozon, integron dhe shenjtëron elemente të krijimit dhe kulturës njerëzore, duke u dhënë atyre dinjitetin e shenjave të hirit, dhe të krijimit të ri në Jezu Krishtin, dhe duke i kërkuar njeriut një qëndrim të veçantë, (Krh. *Katekizmi i kishës Katolike*, nr. 1147 - 1149).

Qëndrimi që duhet të karakterizojë njeriun përpara krijimit është në thelb ai i mirënjohjes, bota në fakt i referohet misterit të Hyjit që e ka krijuar dhe e mbështet atë. Por nëse marrëdhënien me Hyjin e vendosim në thonjëza, natyra zbrazet nga kuptimi i saj i thellë duke e varfëruar atë. Nëse nga ana tjetër, ai arrin të rizbulojë natyrën e tij në dimensionin si krijesë, është e mundur të vendoset një marrëdhënie komunikuese me të dhe kuptimin e tij evokues dhe simbolik, duke depërtuar kështu në horizontin e misterit që i hap kalimin njeriut drejt Hyjit, krijuesit të tokës. Bota i ofrohet vështirimit të njeriut si një gjurmë e Hyjit, vend në të cilin zbulohet fuqia e tij krijuese providenciale dhe shëlbuese (Krh. *Përmbledhje e doktrinës shoqërore të Kishës*, nr. 487).

Paragrafi 36 i kushtetutës së Koncilit II, *Gaudium et Spes* thotë se nëse është për autonomi e realiteteve kohore që dikush dëshiron të mbështesë «se gjërat e krijuara nuk varen prej Hyjit dhe se njeriu mund t'i përdorë ato pa ia referuar krijuesit, atëherë askush që beson në Hyjin nuk mund të mos shohë se sa të rreme janë këto opinione. Në të vërtetë, krijesa pa krijuesin zhduket».

Autonomia e realiteteve tokësore do të thotë që gjërat e krijuara dhe vetë shoqëritë kanë ligje dhe vlera që janë të përshtatshme për njeriun, dhe ai gradualisht duhet ti zbulojë, ti përdorë dhe rregullojë. Sigurisht që ekziston një solidaritet midis të gjitha krijesave për faktin se të gjitha kanë të njëjtin krijues, të gjitha janë rënditur për lavdinë e Tij, (Krh. *Katekizmi i Kishës Katolike*, nr.344). Ndërvlarësia e krijesave është e dëshiruar nga Hyji. Dielli dhe hëna, cedri dhe lulja e vogël, shqiponja dhe harabeli, diversiteti dhe pabarazia e panumërt do të thotë se asnjë krijesë nuk është e vetë-

mjaftueshme që ato të ekzistojnë vetëm në varësi nga njëra-tjetra, dhe për tu plotësuar njëra me tjetrën në shërbim të njëra-tjetrës, (Krh. *Katekizmi i Kishës Katolike*, nr.340). Nuk ka kundërshtim midis qenies njerëzore dhe krijimit. Përkundrazi ekziston një aleancë e qëndrueshme dhe e pandashme në të cilën krijimi lejon ekzistencën dhe zhvillimin e qenies njerëzore, ndërsa njeriu duhet ta fisnikërojë mjedisin me veprimtarinë e tij krijuese dhe prodhuese, me pak fjalë ai duhet të jetë përgjegjës për krijimin. Siç kemi përmendur më sipër krijimi është vendi ku njeriu lindë është shtëpia e tij me të gjitha të mirat e tokës që i janë dhuruar nga vetë Hyji. Në mënyrë që ata të zhvillojnë potencialin e tyre me dashuri dhe me nxitje për të favorizuar rritjen integrale të njeriut. Duhet të kemi të qarte se jemi administrator dhe jo zotërues të një bote që nuk është pronë e jona.

Interpretimi i saktë i konceptit të qenies njerëzore si zotëri i universit është më i madh se ai i të kuptuarit të tij si një administrator i përgjegjshëm, (Krh. *Laudato si*, nr.116).

Mësimi biblik është në kontrast të plotë me ideologjitë imanente të cilat vendosin që në këtë botë qëllimi i njeriut të priret që të justifikojë shfrytëzimin e burimeve natyrore në vend që të ketë një horizont të hapur për mirëqenien e pastër tokësore, (Krh. *Përmbledhje e doktrinës shoqërore të Kishës*, nr. 260).

Në librin e Zanafillës Hyji ia beson krijimin dy njerëzve të parë, në mënyrë që ato ta ruajnë atë duke e kultivuar dhe duke iu drejtuar sipas projektit të Tij, (Krh. Zan 1, 27 -28; 2, 15). Në këtë pjesë të Shkrimit Shenjtë ne mund të lexojmë detyrën e burrit dhe të gruas që ato duhet të kenë për të bashkëpunuar me Hyjin dhe për të transformuar botën përmes punës, shkencës dhe teknologjisë. Burri dhe gruaja janë shëmbëlltyra e Hyjit në këtë shërbim të çmuar që ata duhet të kryejnë, duhet ta realizojnë me të njëjtën dashuri që kishte vetë Krijuesi, (Krh. Papa Benedikti XXI, *VII takimi botërorë i familijeve Milano* 03. 06. 2012).

Duhet të kemi të qartë se jemi kujdestarë për krijimin që është projekti i Hyjit, dhe duhet të kujdesimi për tjetrin, për ambjentin etj. Mos të lejojmë që shenjat e shkatërrimit dhe të vdekjes të na shoqërojnë në ecjen tonë. Për të ruajtur të tjerët më parë duhet të kemi kujdes për vetvetën. Atë që duhet të vërejmë nuk është vetëm një aleancë midis njeriut dhe krijimit, por edhe një ndryshim mes njeriut dhe krijesave. Këtë na e vendos në dukje Shkrimi Shenjtë duke u nisur nga faqet e para vërejmë dallimin që Hyji bën mes çdo gjëje që Ai krijonte (Krh. Zan. 1, 25 ; Zan 1, 31).



GUSTAV SCHORGHOFER S.I

TË ZBULOSH TË BUKURËN SI MUND TË SHPËTOHET BOTA?



Kohëve të fundit flitet gjithnjë e më shpesh për bukurinë, po ky diskutim nuk ka një ndikim të veçantë. Papa flet për bukurinë, kur i referohen artistëve. Përmendet bukuria si një argument në favor të ritit të vjetër liturgjik. Aty – këtu zhvillohen konkurse bukurie. Por çfarë do të thotë bukuria në një botë ku gjithnjë e më shumë tregon gjurmët e një shkatërrimi pa lënë pasoja? “Bukuria do të shpëtojë botën”- ka thënë Dostojevski. Do ta bëjë me të vërtetë? Sot bukuria është gjithnjë e më shumë e barazuar me atë çfarë na pëlqen. Por bukuria është gjithnjë e këndshme? Çfarë ndodh nëse sjell dhimbje e vdekje? Kur flitet për të bukurën duhet të bëhet një pyetje që shkon përtej asaj që është estetike: Çfarë i jep kuptim jetës së individit dhe jetës së një shoqërie? Cila është ajo gjë që i jep kuptim botës sonë? Edhe për thirrjen fetare është e rëndësishme përgjigjja e një pyetje të tillë. Në shoqëritë evropiane duket e qartë që përgjigjja e një pyetje të tillë nuk mund të jetë thjesht e mira e përgjithshme. Shumë më tepër duhet për të pasur një jetë të mirë.

Plotësia e jetës do të eksperimentohet nga ato që e marrin dhe e shijojnë jetën si një dhuratë. Kjo sjellje nuk është një gjë e dukshme. Në ditët e sotme shpesh është ndjesia se secili nga ne duhet të formojë një performancë që justifikon jetën e vet

përballë shoqërisë. Kush nuk është në gjendje që të prodhojë një performancë përgatitet ta bëjë. Njëlloj ndodh me fëmijët, për t’u formuar në të ardhmen, apo si në rastin e personave të vjetër dhe të dobët, gjë që konsiderohet më shumë si një rëndesë që ndërhyr në jetën e të tjerëve. Për atë që e konsideron jetën si një dhuratë, çdo prezencë është e bukur dhe e çmueshme.

Si mund të ushtrohem për të praktikuar një sjellje të tillë? Çfarë mund të bëjmë që jeta jonë të konsiderohet si një dhuratë? Një dhuratë që e ruaj me mirënjohje, ditë pas dite? Mbi të gjitha mund të kultivoj ndjenjën e bukurisë dhe të ruaj cilësinë e të befashuarit. Një mundësi tjetër është ajo e të ushtruarit për të menduar përtej horizontit tokësor. Këto ushtrime mund të jenë një përmbledhje në një të vetme: për të praktikuar sensin e habisë karshi së bukurës, e pikërisht në këtë sjellje të fitosh një gjykim të hapur drejt botës, në një ndërtim të saj in që shkon përtej fuqive të veta. E bukura njihet : gjithçka kemi dhe që na është dhënë është një dhuratë. Diskutimi mbi të bukurën duhet të inspirohet nga poetët dhe artistët nga të dashurit dhe mistikët, pasi tregohet sekret i saj. Kur flitet për të bukurën në kontekstin kishtar, zakonisht i drejtohet artit. Në diskutimin e tij në nder të takimit të artistëve, më 21 nëntor 2009,

Benedeti XVI ka cituar Paulon VI dhe ka thënë : « Kujtohuni se jeni ruajtësit e bukurisë së botës ». Ka pohuar që në vizionin e së bukurës se ndriçon një realitet më i madh : « Jeta e së bukurës na sjell që të pranojmë të gjithën në këtë fragment, të pafundmen në të pafundmen, Zotin në historinë njerëzore ». ky diskutim i Benediktit XVI na bën të kuptojmë se bukuria është një dhuratë që na dhurohet nga Zoti. Flitet për një bukuri autentike dhe të vërtetë. Sot në fakt, bukuria nuk citohet më, por zbulohet: nuk është dhënë thjesht e që të kuptohet me anë të një fjale të vetme, por shfaqet poshtë formave të ndryshme. Sipas kontekstit, ose i referohen vetëm botës së brendshme, ose na bëjnë që të hapim horizontin në një horizont që tejkalon Tokën. Faktorët e tokës nuk janë më të dukshme: bota në të cilën shikohen dhe interpretohen varet nga spektatori dhe nga konteksti në të cilin ai i merr në pyetje. Diskutimi mbi të bukurën është akoma i vlefshëm, por duhet që të frymëzohet nga poetët dhe artistët, nga të dashurit dhe mistikët, pasi sot do të zbulojë vetveten sekretin e bukurisë.

Forca e Zotit tregohet edhe në refuzime

Bukuria, pra, nuk është thjeshtë e pranishme dhe e disponueshme, por duhet të njihet. Saktësia e së bukurës është një proces i të mësuarit të thelluar. Arti i shekullit XX na ka mësuar që të njohim të bukurën në shumë gjëra, për të gjetur edhe aty ku përpara shikoheshin vetëm papastërti dhe refuzime. Kurt Schwitters na jep një shembull të qartë. Rreth 1920-ës, ai që i pari artist që i kushtoj vëmendje çdo lloj refuzimi: mbetje kartonash, letra të këqija, copa drunjsh, kanaçe kallaji, hekuri të ndryshkur, etj. Me të gjitha këto ai ka krijuar copa letre dhe vepra arti më të mëdha, që tregojnë një bukuri mahnitëse në brendësinë e formave dhe ngjyrave.

Vepra e Schwitters ka pasur një impakt të madh përgjatë shekullit XX e deri në ditët e sotme. “Arti i varfër”, si rezultat i dëshirës për të bërë art me materiale të “varfra”-mblidhet në këtë traditë. Natyrisht bukuria e të gjithë këtyre veprave të artit nuk krahasohet me atë që një herë ishte konsideruar e tillë. Për artistët e kohëve moderne deri në fund të shekullit të XX termi “bukuri” kishte një kuptim të ndryshëm, harmonik, të çmueshëm dhe fisnik. Por kjo mund të zbulohet edhe aty ku nuk është kërkuar kurrë më përpara. Një spektator duhet të dijë të peceptojë edhe këtë bukurinë tjetër, pasi ajo nuk imponohet me forcë, në ndryshim nga shumë forma të tjera paraardhëse.

Bukuria e gjërave të vogla, të mbeturinave dhe të humbjeve, është i heshtur. Kërkon durim dhe një spektator të aftë për të pritur. E gjithë kjo, nga një

vështirësi e parë, duket zhgënjyese, por pastaj, pak nga pak, lulëzon te ai shikim me anë të të cilit, që kur ishim fëmijë shikonim botën dhe ishim në gjendje që të njihnim në copat e drujta pak të dukshme, figurat më të mrekullueshme. Është i njëjti shikim me anën e të cilit Shën Françesku vështironte botën: që nga momenti kur nuk zotëronte asgjë, për të dhe objekti më pak i ndritshëm e më i pavlerë bëhej i çmueshëm. Bukuria e zotit shfaqet edhe në këto gjëra. Një kusht ekzistencial për saktësimin e së bukurës është aftësia që të dish të presësh. Pritja në shumë raste mund të mos jetë e vështirë, por kërkon që të kemi pak durim. Çfarë ndodh, në fakt, kur ajo kërkohej në një situatë durimi torturuese, dhe që e ke të domosdoshme? Bukuria që mund të shfaqet edhe në të tilla situata? A është e mundur që nëse e mbajmë dhimbjen për vete të mund të sjellin një bukuri të paimagjinueshme?

Poezia zbulon një vizion të gjerë të jetës

Vepra e Giuseppe Ungarettit, publikuar në 1947 është mbledhje, që mban titullin “Roma e zënë”,-poezi të krijuara në një periudhë tmerrësisht të vështirë, në Romën e viteve 1943 e 1944. Njëra nga to ishte “Lumi im edhe ti”: *“Lumi im edhe ti, Tiber fatal/ tani që nata e shqetësuar rrjedh/ tani që është këmbëngulëse/ është e fortë sa guri/përhapet ankesa e qengjave/ të humbur në rrugët e gjata/ përhapet e keqja pa pushuar/ më e keqja e të këqijave: është pritja së keqes së paparashikuar/ ka shpirtin dhe hapat/ akullon shtëpitë në humnera pasigurie/ tani që rrjedh nata/ që në çdo çast zhduken përplasjet/ shumë vetë i tremben ofendimit/ duke marrë gati forma hyjnore, për të ndriçuar/ për hir të ngritjes në qiell të mijëra njerëzve/ tani që nata erdhi/ e kur një njeri mund të fillojë të mësojë/ tani, tani, kur sllavi/ bota gati mbyl/ tani që torturimi bëhet i padurueshëm/ shfrenohemi kundër vdekjes: tani që guxojnë që të thonë/ blasfemia e buzëve të mia/ Krishti një rrahje zemre mendimtare/ sepse bollëku yt/ është mërguar kaq shumë?”*

Kjo poezi e ka karakterin e një litanie, edhe me shprehjen “tani” të përmendur shumë herë, e përfshin lexuesin në një situatë me një dhimbje të madhe. Duke lexuar përfshihemi gjithnjë e më thellë në të. Duket se dhimbja bëhet e padurueshme dhe që mbetet e hapur një plagë e thellë. Megjithatë, çuditërisht kjo plagë nuk e privon shikimin tonë; përkundrazi: poezia përfshin një vizion të thellë të jetës: një jete karakterizuar nga një plagë e thellë; por që nuk është mundur nga kush. Është pikërisht në këtë pikë që gjuha hapet ndaj një mundësie të

pakundërshtueshme. Tani buzët guxojnë të thonë diçka që mund të na duket blasfemike, po që përfshin një horizont të ri të mrekullueshëm. Krishti është thirrur dhe vendosur përballë një pyetjeje; thirret “Një rrahje-zemre meditative”; një imazh i mrekullueshëm, në të cilin janë bashkuar ndjenja dhe arsyeja. Flitet për një bollëk që duket se largohet, po që në fakt është një lloj e pranishme. Teksti që kemi cituar është e para e tre pjesëve të poezisë. Në pjesën e tretë na krijohet përshtypja e “Krishtit një rrahje-zemre meditative”. Poezia përfundon me një himn, që tregon se pikërisht në vendin e dhimbjes, është një plagë, pasi aty mund të tregohet prania e shpëtimit dhe mund të shkëlqejë një bukuri e papritur.

Këshilli i Vatikanit II kishte pasur pak gjëra për të thënë mbi bukurinë, megjithatë disa nga pohimet e tij, mund të cilësohen si mund të shfaqej ajo. Flitet për thjeshtësinë, maturinë dhe dinjitetin: “Në promovimin dhe kultivimin e një arti të shenjtë, njerëzit e thjeshtë kërkojnë të rigjejnë një bukuri të ndershme sesa thjeshtë të jesh lakmitar. Duhet të mbahen larg kishës veprat e artit që fyejnë besimin e hershëm ose sepse duke i prishur format, ose sepse janë të pamjaftueshëm, mediokër dhe fals një shprehitë artistike”. Kjo mund të simbolizojë shumë gjëra, madje po tregon që Kisha mund të mësojë që të perceptojë një bukuri të ndryshme nga ajo e artit eukaristik të shekullit XIX dhe XX.

Të zbulosh një bukuri të mistershme

Ky tipi tjetër i bukurisë mund të zbulohet përmes një reflektimi mbi Jezu Krishtin dhe mbi mënyrën e tij të të shikuarit të botës. Jezu Krishti pëlqente të varfrit, të dëbuarit, të vegjlit. Në to ai zbulonte bukurinë e shpëtimit, të pastërtisë, të birësisimit hyjnor. Një shembull i kësaj sjelljeje dallohet në parabolën e pastorit, i cili lë 99 delet e tij për të gjetur delen e humbur. Në parabolat e mbretërisë së qiejve Jezusi i referohet gjërave dhe personave të thjeshtë. Në këtë që është e thjeshtë dhe pak e dukshme, ndriçon misteri i bukurisë së Zotit. Po, ndriçon edhe kur çdo bukuri duket se po erret, nga vdekja mbi kryq.

Perspektiva e Jezu Krishtit, natyra e parabolave, e jetës dhe vdekjes së tij ofrojnë një kontekst, në të cilin shumë vepra të shenjta të artit modern dhe bashkëkohor marrin një aspekt të ri dhe të ndryshëm. Ato nuk futen si dëshmie besimit të krishterë, por forma e saj hapet ndaj interpretimeve të tjera.

Kështu, veprat e Francis Bacon (Dublin, 1909-Madrid, 1992), një ndër piktorët më të mëdhenj të shekullit XX, ateist i deklaruar, nuk mund të

interpretohen vetëm si dëshmi të ateizmit të tij. Figurat e mbajtura pezull, bukuria e jashtëzakonshme e mishërimit, të qenit i ekspozuar ndaj figurave, e gjithë kjo merr një kuptim të ndryshëm nga konteksti i një reflektimi të inspiruar nga misticizmi kristian. Del në dritë një bukuri e veçantë: nuk vihen më në dukje gabimet e deformimit, po bukuria e tyre. Manifestohet një botë në një rrezik ekstrem, por që nuk lihet të bihet poshtë. Kush e njeh këtë, mund të gjejë në të tilla vepra, misterin e bukurisë.

Megjithatë e gjitha kjo nuk është vetëm e dhënë, po varet nga vështrimi i atij që vëzhgon dhe nga konteksti i vëzhgimit të tij. Detyra e madhe e të krishterëve është padyshim ai i të mësuarit për të vëzhguar këto vepra, gjithnjë e më shumë në kontekstin e një misticizmi kristian. Në këtë mënyrë, ato arrijnë një dimension të së bukurës, e cila aludon për një realitet jashtë asaj që na është dhënë në Tokë. Një dimension që na mëson të perceptojmë edhe në gjërat e padobishme, për të cilat është thjesht terreni i një realiteti më të madh.

Magjia e mrekullueshme heshtjes

Kur flasim për të bukurën, duhet të nënvizojmë një element që në shekullin XX e deri në ditët e sotme ka marrë një rëndësi të jashtëzakonshme: heshtja. Kuptimi i heshtjes dhe bukuria e pritjes. Të presësh mund të të duket torturuese, ajo mundet edhe të të vrasë, por edhe mund të ketë një magji të mrekullueshme. Për të qenë e bukur pritja bëhet gati për një ardhje të re. Atëherë unë i përdor ndjenjat e mia, e mbaj veten zgjuar, bëhem i ndjeshëm ndaj shenjave të vogla dhe pak të dukshme.

Hera-herës, pritja cilësohet si një rezultat befasues: diçka hapet për mua, por ndonjëherë fshihet, ndonëse unë e di që është gjithçka aty. Të gjithë e dinë çfarë do të thotë të shikosh me durim, gjithnjë e më shumë, veprat e artit, të dëgjosh gjithnjë të njëjtën muzikë, të dëgjosh me vëmendje dikë, ose thjesht të qëndrosh i ulur pa bërë asgjë.

Një pengesë e madhe ndaj bukurisë së pritjes dhe rritja e shpejtë e kohës sonë.

Në artin e shekullit XX, kjo pritje është favorizuar nga mungesa e imazhit. Pasi përballë një imazhi bosh, apo një veli shumëgjyresh apo një kubi të rreptë, nuk ka një përbërje për ta deshifruar. Një muzikë gati e padëgjuar nuk më zvarrit me veten, por unë i kthehem vetvetes dhe më është kërkuar që të hesht. Nuk merrem në pyetje nga asgjë që më shpërqendron. Jam vetëm me vetveten. Ky është momenti, në të cilin bën që tek unë të

rrëshqasë vetë bukuria e pritjes. Sepse në boshllëkun, në asgjënë dhe në heshtjen që krijohet unë zbuloj që tjetri më bie ndesh, qoftë se rrjedhin për mua ngjyrat në bukurinë e tyre, qoftë se manifestohen mrekullia e një tingulli, e një thirrjeje, e një telefonate, apo mrekullia e një takimi.

Bukuria e pritjes konsiston në eksperimentimin e të gjithës si një dhuratë. Kjo është ajo që misticizmi e quan “lavdi”. Shumë nga kishat moderne janë privuar nga imazhet. Ato i krijojnë mundësi takimit me Zotin, si për një njeri që rri qetësisht në pritje, ashtu si për një popull që feston. Shumë piktura moderne janë pa përmbajtje, me sipërfaqe boshe, ose mbajnë një boshllëk të madh. Muzika bashkëkohore krijon momente të gjata dhe të thella heshtjeje: pikërisht këtu gjendet bukuria e pritjes.

Një pengesë e madhe për një bukuri të tillë bën një përdorim të vlershëm të kohës sonë. Sot kush e përdor kohën për të vëzhguar më gjatë sesa 1 moment një imazh? Kinemaja, zhanri më artistik i shekullit XX, lidh në të 2 motive: shpejtësinë e imazheve dhe ruajtjen e tyre. Një film mund të konsiderohet si një imazh, që për t'u rinjohur si e tillë, të kërkon kohë. Duke e parë në këtë këndvështrim, ajo na paraqet ngjashmëri me muzikën. Sipas kësaj perspektive edhe liturgjia mund të shikohet si një vështrim mbi jetën.

Prezenca e të vuajturve dhe emigrantëve

Gjithnjë mund të gjendet e bukura, edhe në detaje, por është vetëm në kontekstin e të gjithave që mund të manifestohet një bukuri e ndryshme, që qëndron më gjatë. Duke i referuar liturgjisë, kjo tregon që thjeshtësia, momentet e heshtjes, gjestet dhe veprimet pak të dukshme e marrin vlerën e tyre vetëm në raport me kontekstin. Kur flasim për kontekstin e bashkësisë, nuk i referohemi thjesht veprave të vetme, por edhe jetës së tërë, botës. Sot është rreziku që estetika ndan sektorët e pjesshëm të jetës nga konteksti i tyre, duke iu atribuar atyre një magji të veçantë. Një pjesë e natyrës, sektorëve të bashkëjetesës njerëzore, objekte apo vende zhvillojnë, sipas eksperiencës estetike, një bukuri mahnitëse. Edhe gjërat e vogla edhe pak të dukshme bëhen vendi i një shfaqjeje të një plotësie të papritur.

Fenomeni i së bukurës shpëputet nga e mira, e cila kërkon të mos harrojmë botën e të vuajturve edhe të mërgimtarëve. Kush i dedikohet një soditjeje të së bukurës, përvetëson disa sektorë të botës, duke përjashtuar pjesën tjetër: përjashtohet hapësira e dhimbjes, e kërcënimit edhe e vuajtjes.

Estetika harron dhembshurinë. Ajo krijon një botë të vetën, e cila mund të jetë artistike, por mbyllet në botën e vuajtjes. Për ato që vuajnë nuk duhet të pretendojmë vetëm ato, për të cilët ekzistenca janë kërcënime për sëmundjet dhe luftërat, por edhe ato persona, që janë lidhur me kufijtë e shoqërisë dhe ekzistenca e tyre është e fortë e me plot privilegje. Bota e të vuajturve mund të modelohet artistikisht vetëm duke hyrë në kontakt me të. Kjo ka ndodhur disa herë, duke filluar nga “Los desantres de la guerra të Goyas”, në fillim të shekullit XX. Poezitë e Ungaretit na paraqesin një shembull perfekt. Mes shumë librave me fotografi të shekullit XX, dy janë ato të cilët duhet t'i kujtojmë në veçanti: “Roma” e shkruar nga Josef Koudelka, e publikuar për herë të parë në 1975, e përbërë nga 60 fotografi të romëve të Çekosllovakisë së epokës; edhe vepra “In the American West”, e Rikard Avedon, e botuar më 1985. Për të krishterët, për t'ju referuar artistikisht jetës dhe vuajtjeve të të tjerëve lidhet me të drejtuarit e Zotit që i bën botës, në mishërimin e Jezu Krishtit.

Kisha perëndimore në shumë mënyra e ka humbur kuptimin e së bukurës, e po ashtu siç ka humbur raportin me artin bashkëkohor. Nuk bëhet fjalë vetëm për mbrojtje e të ruajtur format e së bukurës tradicionale- ashtu siç pohojnë kundërshtarët e rinovimit liturgjik dhe mbështetësit e liturgjisë së vjetër, - por për të rinjohur bukurinë e kësaj bote në kontekstin e mesazhit evangjelic. Me fjalë të tjera, bëhet fjalë për të jetuar një pëlqim estetik për të varfrit, emigrantët dhe ato që harrohen pa u përmendur. Vetëm kur te personat që nuk bijnë fort në sy dhe përbuzen do të perceptohet bukuria, dhurata e jetës do të mund të njihet edhe në këto ambiente. Në njohjen e së bukurës, ndriçon dhurata e jetës.

Përktheu: Bernardina Shahini

Material i përkthyer nga revista kulturore – fetare “La civiltà cattolica”, 2020.



IMZOT ERNEST ÇOBA: MIKU I SKAMNORËVE, KLERIKU QË NUK U THYE KURRË

*Konferencë, më 19 shtator 2020, në Sallën “Kardinal Mikel Koliqi”
të Famullisë së Shën Shtjefnit Shkodër.*

“Imzot Ernest Çoba: miku i skamnorëve, kleriku që nuk u thye kurrë” është konferenca e zhvilluar me rastin e 40-vjetorit të kalimit në amshim të këtij Prelati të lartë të Kishës katolike në Shqipëri, organizuar nga Komisioni “Drejtësi e Paqe” dhe Muzeu Dioqezan Shkodër-Pult.

Kjo konferencë, e cila u mbajt më 19 shtator 2020, në Sallën “Kardinal Mikel Koliqi” të Famullisë së Shën Shtjefnit Shkodër, ishte parashikuar që të mbahej më 18 prill 2020, por prej kufizimit të lëvizjes për shkak të pandemisë së sëmundjes COVID-19 u shtye për një datë të dytë.

Pas përshëndetjes së mirë-seardhjes, bërë nga moderatorja Znj. Loreta Tomaj, në fjalën e tij të hapjes, Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult, theksoi se ngjarje të tilla kulturore “na japin mundësi edhe që të vihem në kontakt me ato pjesë të historisë sonë që jo gjithmonë i njohim apo që mendojmë se i njohim mirë; pikërisht siç ndodh edhe me figurën e Imzot Ernest Maria Çobës, për të cilin të gjithë mendojnë se ka qenë Arqipeshkëv i Shkodrës, kur në fakt ishte ipeshkëv titullar i Midesë dhe vetëm Pro Vikar i Arqidioqezës së Shkodrës”.

Prof. Dr. Romeo Gurakuqi, i angazhuar në Departamentin e Historisë Bashkëkohore, të Institutit të Historisë, bëri një ekskurs të shkurtër të krejt historisë së Kishës katolike në Shqipëri, duke u ndalur veçanërisht në historinë e saj të shek. XX dhe të pasojave që solli “revolucionin kulturor” në komunitetin katolik të asaj kohe dhe jo vetëm. Ndër të tjera, Z. Gurakuqi pohoi se “(...) katolikët luajtën një rol vendimtar për shpëtimin e kombit, ruajtjen dhe forcimin e gjuhës shqipe, edukimin e dashurisë për atdheun dhe për vëllezërit e tyre myslimanë, (me) të cilët bashkërisht vuanin (...)”.

Z. Gjovalin Çuni, ish-drejtor i Bibliotekës “Marin Barleti” të qytetit të Shkodrës, pasi bashkëndau me të pranishmit faktin se e kishte njohur personalisht Monsinjin, siç e quan ai, dhe se ishte krezmuar prej tij, kështu e paraqiti figurën njerëzore dhe të krishterë të Imzot Çobës: “Monsinjori, çdo ditë të javës, pasi mbaronte Meshën e orës 06.00, dimër e verë, vizitonte të sëmurët e qytetit, sidomos ata që ishin ndër kolibe e baraka, në lagjet e humbura të qytetit, duke u çuar atyre jo vetëm fjalët e Ungjillit dhe të Biblës, por edhe bukën materiale, qoftë në kohën kur qe priift, qoftë në kohën kur u bë ipeshkëv”.

Dëshmia e Dom Gjergj Simonit dhe dokumentari i përgatitur me këtë rast e pasuruan edhe më tej njohjen e figurës së Imzot Ernest Çobës, njohje kjo që mori një trajtë edhe më të plotë dhe më prekëse prej dëshmisë së djalit të motrës të Imzot Çobës, Z. Ernesto Rini



Andracchio-s, i cili, plot përmallim, vuri në dukje dy karakteristika të dajës së tij: thjeshtësinë me të cilën ka jetuar, edhe kur ishte Prelat i lartë i Kishës, dhe afërsinë që ka treguar ndaj të varfërve dhe të sëmurëve.

Një ndërhyrje mjaft interesante dhe profesionale, në video-konferencë, ishte edhe ajo e Dr. Lisandri Kolës, nga Ann Arbor (Michigan-Sh.B.A), i cili, ndërsa referoi për Imzot Çobën si përkthyes e poet, kështu e paraqiti karakterin letrar të rinisë së tij: “Dorëshkrimi që i asht paraqitë sot lexuesit (Keze të Hueja), tregon për një karakter letrar të rinisë së Monsinjin, i cili sintetizon në formim dy shkollat letrare shkodrane, tashmë kanonizue prej Profesor Ernest Koliqit, sisteme që kanë ndikue krejt zhvillimet e mavona letrare, përkthimore e gjuhësore në kulturën shqipe. Klasicizmi i Çobës ka ndihmue me pëртеjsue edhe ndonji mbërritje përkthimi që deri atëherë ishte ba në Shqipni, e veçmas në traditën geqe. Duhet thanë se vizioni i Monsinjin asht me i përbashkue sistemet letrare tradicionale të shqipes dhe me u lanë shteg njëkohësisht nëndialekteve a idiolekteve përkrah fertilitetit gjuhësor”.

Në fund, pjesëmarrësit mundën ta kishin ndër duar këtë libër me përkthime dhe krijime letrare të Imzot Çobës, përgatitur dhe pajisur me shënime përkatese filologjike dhe gjuhësore po nga Dr. Lisandri Kola.

Njoftimi për botimin e shpejtë të këtyre referateve në një libër të vetëm shënoi edhe mbylljen e kësaj konference të shumëdëshiruar.


AT SHTJEFËN GJEÇOVI, KOLOSI I FESË E ATDHEUT, NË 91-VJETORIN E VRASJES

Françeskani At Shtjefën Gjeçovi ishte dhe mbeti pishtar i gjallë i ndriçimit të historisë dhe kulturës së kombit të tij, të cilat u bënë për të pajë shpirtërore dhe qëndrese deri kur dha edhe frymën e fundit.

R.SH. Vatikan 14. tetor 2020

Më 14 tetor, kujtojmë 91-vjetorin e vrasjes mizore të fratisë së studiuesit të madh, Atë Shtjefën Konstandin Gjeçovit, më 14 tetor 1929 në fshatin Zym të Hasit, afër Prizrenit. At Shtjefën Gjeçovi, françeskan shqiptar kosovar, është një nga figurat vigane që krishterimi shqiptar i fali kulturës kombëtare, i cili për kontribut të tij, radhitet përkrah gjenive të tjerë të krishterimit ndër shqiptarë, si imzot Pjetër Budi, imzot Pjetër Bogdani, imzot Gjon Kazazi, At Gjergj Fishta, At Anton Harapi e shumë e shumë të tjerë.

Po e përkujtojmë figurën e tij poliedrike të rëndësishme për Kishën dhe kulturën shqiptare, me sivëllain e tij të françeskan, At Ndue Kajtazin nga Zymi, vend ku At Shtjefën Gjeçovi e dha jetën për Krishtin dhe Popullin e tij shqiptar. Ta përcjellim bisedën që zhvilluam me françeskanin Atë Ndue Kajtazin nga kuvendi françeskan i Gjakovës..



Sapo kujton emrin e At Shtjefën Gjeçovit (1874-1929), edhe më të fundmit të shqiptarëve që ka pasur rastin të bëjë qoftë edhe dy klasë shkollë, do t'i vejë menjëherë mendja te "Kanuni i Lekë Dukagjinit", mbledhur e kodifikuar nga frati i madh. Po Atë Shtjefni ishte më tepër se kaq.

Një nga figurat më poliedrike që njeh historia e kulturës shqiptare, At Shtjefën Gjeçovi pati etjen e pashuar të gërmonte nga pak në të gjitha fushat e diturisë. Mahniti me kulturën e tij Faik Konicën, i cili e përshkruan me nderim e simpati të thellë në parathënien e Kanunit; la pa mend shkrimtarin e ri modern të Shkollës letrare të Veriut, Dom Lazër Shantojën, edhe ky martir i krishterimit gjatë diktaturës, i cili i kushtoi portretin më të bukur që është shkruar për të, duke e radhitur përkrah Fishtës e Harapit. Ai mbeti në kujtesën e të gjithëve si një nga historianët, etnografët dhe arkeologët e parë shqiptarë.

At Shtjefën Gjeçovi lindi më 12 korrik 1874, në Janjevë të Kosovës në një familje thellësisht

katolike. Në pagëzim ia vunë emrin Mëhill e shkurtimisht e thirrën Hilë. Që i vogël shfaqti shenja jo të zakonshme zgjuarsie, prandaj famullitari françeskan, me leje të prindërve, e mori një ditë për dore dhe u nis bashkë me të për në Shkodër, në Kolegjin françeskan. Gjeçovi ishte vetëm 10 vjeç kur veshi zhgunin e murrme, të lavdishëm, të fratisë. Vijoi mësimet në Troshan, Fojnicë, Dërventë, Kreshevë, përgjithësisht në Bonjë-Hercegovinë, ku është përgatitur një pjesë e mirë e françeskanëve shqiptarë, ndërmjet të cilëve, Fishta. Më vonë françeskanët e rinj do të merrnin rrugët drejt Austrisë e Italisë.

Nisi të interesohet për gjithçka kishte të bënte me historinë e popullit të vet: për fillimet e krishterimit, për arkeologji, etnografi, gjuhësi, letërsi e natyrisht edhe të hidhte në letër shkrimet e para, pa harruar kurrë se detyra e tij kryesore do të ishte predikimi i Ungjillit të Krishtit.

U kthye në Troshan më 1896, 22 vjeçar, famullitar i ri me fe të gjallë e kulturë të thellë. At

Shtjefën Gjeçovi predikoi Ungjillin në Rubik, Pejë, Laç-Sebaste, Zarë, Sapë, Theth, Prekal, Vlorë, Shkodër, Gjakovë e Zym, ku u ndal për pushimin e mbramë! Kulmin e krijimtarisë e arriti në vitet 1900, kur u bë i pranishëm në të gjitha fushat e kulturës e të arsimit.

Shkroi në të tria gjinitë letrare, mblodhi këngë, përralla, mite, doke e zakone popullore e, mbi të gjitha, atë që do ta pavdekësonte, "Kanunin e Lekë Dukagjinit" monument i gjuhës dhe i kulturës së Kombit Shqiptar, për të cilin Universiteti i Lajpcigut i dha titullin "Doktor i shkencave in honoris causa".

At Shtjefën Gjeçov mblodhi gojëdhana, zakone, visar gjuhësor. Përgatiti monografi shkencore historike, etnologjike, arkeologjike, petagogjike, kodifikoi të drejtën zakonore shqiptare, shkroi artikuj publicistikë, hartoi tekste mësimore, krijoi një koleksion të pasur arkeologjik, shkroi drama e tragjedi, poezi e romane, përktheu letërsi botërore në gjuhën shqipe e vepra fetare, përgatiti vëllime me dokumente për historinë e popullit shqiptar, shkroi artikuj e studime historike.

Po kujtojmë disa prej veprave të tij: "Dashnia e atdheut", drama "Agimi i qytetnisë", "Shqiptari ngadhënjyes", "Përkrenarja e Skënderbeut", botimi i "Kanunit të Lekë Dukagjinit", vepra "Trashëgime trako-ilire", "Jeta e Shën Luçisë, Shna Ndou i Padues, Atil Reguli" – përkthim i lire i dramës me 3 akte të Pjetër Metasatasit, "Vazja e Orleans-it ose Joana D'Ark" mbas A.F. prej Bergamos dhe vepra e fundit teologjike "Shpërbleti i botes ase Jeta e Jezu Krishtit", të cilën e shkroi me qellim që të mësojë dhe edukojë popullin në frymën e gjuhës shqipe dhe në frymën e dashurisë së Jezusit.

Shumica e veprave i mbetën në dorëshkrim. Madje edhe "Kanuja" u botua pas asaj dite ogurzezë të 14 tetorit të vitit 1929, kur ra nën plumbat e tradhtarëve, duke shuguruar me gjakun e vet bucat e asaj toke, për të cilën kishte shkrirë jetën, të cilat nuk lageshin për herë të parë me gjak frati.

Ai vetë pati mbledhur, sipas të gjitha kritereve, të dhënat për të lartuar në altar një tjetër frat shqiptar, At Luigj Paliqin, martir i fesë e i atdheut. E ndërmjet shkrimeve të shumta kushtuar At Gjeçovit, po kujtojmë se për të është shkruar edhe një monografi me titull "Shtjefën Gjeçovi: Jeta, vepra" me autor Ruzhdi Matën. Gjithsesi shkrimet më të besueshme për të janë ata që mbajnë nënshkrimin e sivëllazënve të tij françeskanë,

të cilët e njohën nga afër, sidomos At Pashkë Bardhit, historianit të fretërve.

Duke kujtuar sot At Gjeçovin, bëme vetëm një skicë të shpejtë të një figure që i ngriti vetvetes me vepra një monument të pashterueshëm nga koha, sepse françeskani At Shtjefën Gjeçovi ishte dhe mbeti pishtar i gjallë i ndriçimit të historisë dhe kulturës së kombit të tij, të cilat u bënë për të pajë shpirtërore dhe qëndrese deri kur dha edhe frymën e fundit.

"Giuha e një komit s'kaa t'ndalun, as nuk mûnd t'ndâlet kurr". "Sa mûnd t'mëndohet dielli pa dritë, aq mund t'mëndohet komi pa giuhë". Ai i bën të ditur patriotëve të tij vlerat e gjuhës sonë, pasi ajo... "është një gjâa sënd qi nuk mûnd t'blehet, nuk shitet e nuk ndrrohet; një sënd është, qi do t'ruhet si një gur i çmue, do t'ruhet si një dhântii e posaçme e Perendÿs e si një trashigim i t'parvet tonë... do t'ruhet si drita e synit. Kjo dhântii... është giuha shqype". E mbyll paragrafin, duke vendosur në fund këtë aforizëm: "Sa mûnd t'mëndohet dielli pa dritë, aq mund t'mëndohet komi pa giuhë".

Atë Ndue Kajtazi



**MESHTARËVE, RREGULLTARËVE, RREGULLTARËVE DHE BESIMTARËVE
TË ARQIDIOQEZËS SHKODËR-PULT**

Të dashur,

Përshëndetja ime e paqes në Zotin arriftë te të gjithë ju.

Me muajin Shtator kemi filluar një Vit të ri baritor të shënuar, për fat të keq, nga një situatë serioze pandemike, e cila nuk e ka ndër mend të largohet dhe që, madje, - siç e dini - shënon raste të reja edhe midis anëtarëve të klerit dhe të rregulltarëve.

Dëshiroj edhe një herë që t'u bëj një ftesë serioze të gjithëve ju, me qëllim që të tregoni kujdesin më të madh në zbatimin e rregullave të nxjerra nga Shteti për parandalimin, si edhe të rregullave që, së bashku me Kolegjin e Konsultorëve, kishim dhënë disa muaj më parë dhe që mbeten ende në fuqi. Bashkangjitur me këtë letër, jua propozoj përsëri ato letra dhe ju nxis fuqimisht që ta zbatoni përmbajtjen e tyre.

Për t'jua rikujtuar ato rregulla jam shtyrë prej asaj që kam parë personalisht, meqë kam qenë në komunitete të ndryshme gjatë kësaj periudhe për kremtime të ndryshme. Kam vënë re se ato nuk janë zbatuar në mënyrë rigorozë nga të gjithë: mungojnë dizinfektuesit në hyrje, shumë pak besimtarë mbajnë maska mbrojtëse, ambientet nuk dizinfektohen. Përtej këtyre mangësive, ekziston mendësia e përhapur, pothuajse fataliste, që i atribuon Zotit vullnetin apo jo që dikush sëmuret ose vdes.

Epo mirë, Zoti nuk e do të keqen tonë! Ky është një pohim biblik, që hedh poshtë krejt fatalizmin dhe kërkon me forcë përgjegjësinë personale të secilit në dashurinë dhe respektin për jetën vetjake dhe atë të tjerëve. Të kujdesesh për veten dhe për të tjerët është një veprim dashurie/bamirësie! Askush, pra, nuk është i përjashtuar prej tij, sepse bamirësia nuk ka vetëm një funksion "kurues", kur dëmi bëhet, por edhe një funksion "parandalues", kur mund të bëhet ende diçka për ta shmangur më të keqen.

Më lejoni t'ju kujtoj atë që thonë shkencëtarët: jemi ne që e transmetojmë virusin, nëse nuk jemi të kujdesshëm!

Pas kësaj hyrjeje, që e konsideroj të rëndësishme dhe absolutisht për ta përdorur si objekt reflektimi dhe zbatimi, ashtu si edhe Papa na nxit të bëjmë, po vijoj me fillimin e Vitit Baritor, që, në Projektin tre-vjeçar të paraqitur në Letrën time baritore "Gëzimi i dëshmisë", është viti i misionit, me titull: "...dhe çdo gjuhë të dëshmojë: Jezu Krishti është Zot!".

Zyrat e interesuara për fillimin e këtij viti janë Caritas-i dhe "Drejtësi e Paqe", të cilat janë duke

bashkëpunuar për të realizuar nisma të përbashkëta (se bashku me Muzeu Dioqezan) disa prej të cilave janë organizuar me rastin e muajit Shtator kushtuar Mbrojtjes së Krijimit, por që, për fat të keq, nuk kanë qenë të suksesshme jo aq për shkak të motit të keq (falënderojmë Zotin për dhuratën e shiut!), por kryesisht për shkak të mungesës së përgjigjes nga bashkësitë e krishtera dhe nga Shkollat katolike.

Shfrytëzoj rastin për t'ju nxitur që t'u përgjigjeni ftesave që ju bëhen: është shenjë edukate dhe fryme bashkëpunimi.

Pasi mbyllëm muajin Shtator, i kushtuar Botes se Krijuar, me festën e Shën Françeskut, muaji Tetor do të na shohë të angazhuar në kremtimin e Muajit Misionar, kaq i dashur për Papa Françeskun. Le të mos i zhgënjejmë pritshmëritë e Atit të Shenjtë, duke mirëpritur mesazhin e tij, duke sensibilizuar një veprim misionar me lutje dhe një bashkëpunim aktiv për përhapjen e Ungjillit në bashkësitë tona dhe në ato më të largëtat, duke mbështetur misionarët edhe me ofertat tona.

Do të jetë shqetësimi im t'ju jap udhëzime të tjera baritore për muajt në vijim. Tani për tani, e kam për zemër t'ju ftoj të gjithëve për sensibilizimin dhe lutjen për thirrjet, duke ju kujtuar se prej 4 vjetësh askush nuk ka hyrë në Seminar prej Arqidioqezës sonë (dhe Kongregatat e rregulltarëve/reve nuk kanë thirrje!). A është vetëm një problem emigrimi? Le ta pyesim veten seriozisht, para Zotit, edhe mbi përgjegjësitë dhe lëshimet tona të mundshme.

Pa humbur guximin, por të fortë në fe dhe mbi të gjitha të gëzuar në shpresë, le ta fillojmë ecjen e këtij viti të ri, duke besuar në mëshirën e Zotit dhe duke ripërtërirë angazhimin tonë apostolik, secili sipas gjendjes së tij të jetës. Familjet kanë detyrën që t'i edukojnë fëmijët e tyre me fe dhe dashuri, përmes dëshmisë konkrete; rregulltarët dhe rregulltaret kanë detyrën që të dëshmojnë bukurinë e dhurimit total Zotit dhe shpresën e të mirave të ardhshme; priftërinjtë kanë detyrën që të shoqërojnë ecjen e të krishterëve, si barinj që i referohen priftit të vetëm të lartë dhe të përjetshëm, Jezu Krishtit, Bariut të Mirë.

Si ipeshkëv, lus për të gjithë juve, duke kremtuar për juve Eukaristinë e përditshme; dhe për të gjithë dëshiroj një të ardhme në bashkim të plotë me Atin, Birin dhe Shpirtin Shenjt.

Ju bekoj.

† *Angelo Massafra O.F.M.*
Arqipeshkvi juaj

VIZITA E ARQIPESHKVIT NË SHALË – SHOSH

DHE BEKIMI I KISHËS SË VOGËL NË NDREAJ (SHOSH) KUSHTUAR SHËN ILLISË PROFET DHE TË LUMËVE MARTIRË TË SHQIPËRISË

Në muajin gusht të vitit 2019, pas Vizitës Baritore në Dukagjin, së bashku me Atë Aurel Gjerkaç O.F.M., Administrator Famullitar, vendosëm të bënim disa punime.

Me këtë rast, në personin e Atë Aurelit, falënderoj të gjithë Fretërit françeskanë, të cilët vazhduan të shërbejnë në Shalë të Dukagjit, pas ndërprerjes që u bë në vitin 2000, kur u krijua dioqeza Pult-Bajzë, e cila pastaj, në vitin 2005, u shkri në atë të Shkodër-Pultit.

Së bashku kemi vendosur që të vëmë dorë:

- në rrethimin e kishës së Thethit dhe në rindërtimin e çatisë;
- në restaurimin e kishave të vogla të Gimajve dhe të Ndreajve, shumë të prishur.

Për Kishën e Gimajve dhe Ndreajve u kemi bërë kërkesa bamirësve dhe Provania na ka ardhur në ndihmë. Provinca Françeskane Shqiptare ka financuar rrethimin e kishës së Thethit, restaurimin e çatisë, ka riparuar çatinë, lyer kishën në Breg të Lumit dhe ka shtuar shumën që mungonte për përfundimin e punimeve për restaurimin e Kishës në Gimajve. Pas një viti, më 16 gusht, Atë Aureli ka kremtuar Meshën e shenjtë me rastin e festës së Shën Rrokut, të cilës i është kushtuar kisha e vogël e Gimajve.

Më 9 shtator kemi shkuar në Theth, ku paradite kemi kremtuar Meshën shenjte dhe kemi bekuar punët e bëra, pasdite kremtuam Meshën në Breg të Lumit dhe qëndruam me besimtarët në një momet vëllazëror; ndërsa më 10 shtator kemi kremtuar



Meshën dhe bekuar kishën e vogël dhe e bukur të Ndreajve, të cilën ia kemi rikushtuar Shën Elisë Profet duke shtuar edhe Martirët e Lumë të Shqipërisë, për dashuri të tyre dhe në kujtim të të Lumit Gjellosh Lulashi dhe të të Lumit Atë Çiprian Nikaj, që me siguri janë lutur në këtë kishë të vogël.

Në këtë bekim ishim të pranishëm, unë Imzot Angelo Massafra O.F.M., Atë Aurel Gjerkaç O.F.M., Kustod dhe Administrator Famullitar i Shalës, Atë

Luigi Cannato C.M., Përgjegjës baritor i Pultit, Motër Sandra Bartolotto, Motër Françeskane e Krishtit Mbret, Përgjegjëse baritore e Pultit, dhe besimtarë të fshatit, të cilët ishin fort të gëzuar për këtë gjë.

Falënderova bamirësit, pastaj punëtorët, të cilët kanë bërë një punë të shkëlqyer, duke e kthyer një “gërmadhë” në një kishë të bukur, ku besimtarët mund të luten më mirë dhe ku familjet e mbetura në këtë zonë mund të takohen në emër të Zotit.

Kronisti



25 VJETORI MOTRAT “OBLATA ZOJES RRUZARE” NË BARDHAJ

1995 – TETOR 2020

Te dashur banor te fshatit Bardhaj!

U mbushen 25 vite qe kur erdhëm për herë të parë në këtë fshat.

25 vite pune e përkushtuar dhe me shume dashuri për te përmirësuar jetën tuaj dhe të fëmijëve tuaj.

Kur erdhëm për herë të parë me 18 tetor 1995 ajo qe na ra në sy menjëherë ishte infrastruktura e tmerrshme, uji i ndotur nëpër rrugë, fëmijë të uritur, të zverdhur, varfëri ngado. Por vumë re mbi të gjitha varfërinë shpirtërore dhe nevojën e këtyre njerëzve për Zotin.

Mungonte krejtësisht edukata fetare e për rrjedhoje njerëzit silleshin ashpër. Kështu kuptuam qe na priste një pune e madhe dhe vendosem që të rrinim këtu mes jush.

Me 21 tetor 1995 u kremtua Mesha e pare nga dom Natale Mantovani në oborrin e një shtëpie.

Kishte njerëz qe nuk i njihnin fare ritet fetare. Kështu qe duhej filluar sa me shpejte katekizmi, kështu me 24 tetor filluam.

Duheshin pagëzuar e krezmuar fëmijë, të rinj e te rritur qe vinin nga një sistem ateist.

Me 6 janar 1996 u bë pagëzimi i parë në Katedrale dhe, me pas, në fshatin u be një festë e vogël ne Kishë. Na u deshe një punë e madhe qe njerëzit të fitojnë edukatën fetare por kjo gjë u rrit dhe me gatishmërinë dhe dëshirën tuaj qe ishit të etur për fjalën e Zotit. Me 13 prill u vendos kaponi dhe me 20 prill ka filluar aktiviteti. Ky kaponi përdorej për ambulancë, rrobaqepësi, katekizëm, shkolle kundër analfabetizmit, kurse italishteje e vendin për lutje dhe me 8 mars Imzot Fran Ilia celebroidi Meshën ne këtë kaponi.

Për ne ishte një gëzim dhe nxitje për të vazhduar përpara kur monsinjori vuri ne dukje punën tonë duke u shprehur më shumë emocion dhe më pak fjalë: Këto motra po mbjellin dashuri ne këtë vend. Të lutemi për to.

Duke filluar lutjen e Zojes Rruzare qe e kishte përkthyer, vete shpreh se kjo lutje për këtë fshat me mbush me gëzim. Dhe tha: “Po bijtë e mijë, lutemi e falënderojmë bashke Zotin!” dhe sytë i shkëlqenin.

Midis problemeve qe na shqetësonin dhe ne duhej të vepronim shpejt, ishte shëndeti i fëmijëve. Doktorësia qe ne morëm, konstatoi se fëmijët vuanin nga anemia dhe rakitizmi. Për këtë ne siguruam qe fëmijët të ushqehen dhe kurohen në mënyrë qe të rriten të shëndetshëm. Fshati filloi qe të popullohej nga njerëz qe vinin nga zonat malore. Vumë re që fëmijët e tyre nuk kishin fare arsim, për këtë hapem një klase dhe morëm një mësuese për shume vite deri sa analfabetizmi u zhduk. Pastaj

erdhi viti i frikshëm 1997: të gjithë e dimë si rrodhen ngjarjet dhe çfarë situatë e tmerrshme ishte. Por ne zgjodhëm që të mos largohemi por të qëndrojmë këtu me ju, duke mos e ndërprerë aktivitetin për asnjë çast. Me 3 prill 1997 u realizua Udhë e Kryqit ne Bardhanjor për herë të parë qe me pas filloi dhe u be traditë.

Me prill 1998 filluam kopshtin. për ne ishte e rëndësishme të kujdeseshim për shëndetin e fëmijëve pasi, për shkak të varfërisë, ishin shume të dobët duke i ushqyer sa me shëndetshëm. Këtë punë kaq i bukur, nuk këna ndërprerë deri sot. Këtë e bëmë duke ndihmuar edhe familjet e tyre me ushqime, veshje, ne shumë raste duke ndërtuar edhe shtëpi, ilaçe aq sa mundeshim. Prindërit ishin të kënaqur me punën tone dhe kjo na gëzonte. Këta fëmijë sot janë prindër dhe, duke i pare të sjellin fëmijët e tyre ne kopshtin ku kanë qen[vetë, ne mbushemi me gëzim dhe falënderojmë Zotin.

Me 3 qershor 2000 vendoset guri i parë në themelet e Kishës se re nga Imzot Angjelo Massafra qe ju drejtua popullit duke thënë: “Ju jeni guri i gjallë, ju jeni kisha”, dhe fale Zotit se bashku me Kishën e re, kemi mbjelle fenë dhe shpresojmë dhe lutemi qe këtë dritë e këtë dashuri qe kemi ndezur të mos fiket kurrë. Kujtojmë se Zoja Rruzares Pompejt ka ardhur këtu dhe qëndron me ne, si një nënë e mirë dhe e mëshirshme qe kujdeset për ne të cilët mund te përkushtohemi krejtësisht bashke me problemet tona dhe të mos harrojmë Rruzaren Shenjte në familjet tona e sidomos ne këtë kohë të vështirë të Korona-virusit.

Dhe tash mbas këtyre 25 viteve vërejmë me kënaqësi këto ndryshime të mëdha qe kemi arritur se bashku, dhe për këtë falënderojmë Zotin dhe Zojën Rruzare. Dhe për gjithë këtë kërkojmë një gjë nga ju: Lutuni për Ne.

Moter Erminia



**KALIMI I ADMINISTRIMIT TË KISHAVE
TË OBOTIT TË VJETËR DHE TË OBLIKËS
Shtator 2020**

Të dielën, më 20 shtator 2020, shoqëruar dhe paraqitur prej Arqipeshkvit të dioqezës sonë Shkodër-Pult, Imzot Angelo Massafra O.F.M., kam bërë hyrjen time zyrtare në kishën e Obotit të Vjetër (ora 10.30) dhe në atë të Oblikës (ora 18.00).

Në prani të ish-Famullitarit, Dom Rolando Reda-s Orionin, Arqipeshkvi u kujtoi këtyre dy bashkësive gjërat e mira, që Dom Rolando-ja ka bërë përgjatë këtyre 20 viteve shërbim baritor: ndërtim sallash liturgjike dhe katekistike, vizita në familjet e besimtarëve dhe mbështetje e popullit të Hyjit në çdo formë.

Lotët e derdhur gjatë Meshës së shenjtë të përshëndetjes së Dom Rolando-s kanë qenë shenjë pikërisht e këtij angazhimi në shërbim të më të varfërve të këtyre zonave.

Arqipeshkvi, duke na falënderuar të dyve, na uroi fillim të mbarë në detyrat e reja që na janë besuar.

Më pas, po në prani të Arqipeshkvit, ndërsa ishim në Bashkësinë e Fretërve Kapuçinë, Dom Rolando-ja më dorëzoi regjistrat famullitarë, vulat dhe arkat e të dyja kishave.



Të mërkurën, më 23 shtator 2020, Imzot Angelo Massafra O.F.M., duke përfutur prej kremtimit të Meshës së shenjtë në kujtim të shenjtit kapuçin të stigmatizuar, Shën Piut nga Pietrelcina, lexoi publikisht Dekretin e Betimit, të cilin unë e nënshkrova në prani të Tij, të Atit Delegat të Fretërve Kapuçinë, Fra Bonaventura Mossuto-s, të Guardianit të Vëllazërisë së Taraboshit, Fra Matteo Di Seclì-së, dhe të një turme të madhe besimtarësh.

Fra Dario Ardillo, Kapuçin

PAPA FRANÇESKU: ME 4 SHTATOR: DITA LUTJEJE PER LIBANIN

“Dëshiroj t'i ftoj të gjithë që të jetojnë një ditë të gjithëmbarshme lutjeje dhe agjërimi për Libanin, të premtën, më 4 shtator. Këtë ditë kam ndërmend të dërgoj një përfaqësues timin në Liban për të shoqëruar popullatën. Sekretari i Shtetit do të shkojë atje në emrin tim. Ai do të shkojë për t'i shprehur popullit libanez afërsinë dhe solidaritetin tim ndaj tyre. Le ta ofrojmë lutjen tonë për krejt Libanin dhe Bejrutin. Le të jemi afër tyre edhe me angazhimin konkret të dashurisë dhe të bamirësisë, siç kemi bërë në raste të tjera të ngjashme. Edhe vëllazërit e motrat e konfesioneve dhe të traditave të tjera i ftoj që t'i bashkohen kësaj nisme në mënyrën më të përshtatshme për ta, por të gjithë bashkë”.

Me këto fjalë Ati i Shenjtë Françesku ka lajmëruar se nesër, më 4 shtator, do të mbahet një ditë lutjeje dhe agjërimi i gjithëmbarshme për Libanin dhe Bejrutin.

I bashkohemi thirrjes së Papës: të gjithë besimtarët e Arqidioqezës sonë janë të ftuar që të luten, me qëllim që Libani të ringrihet dhe të gjejë forcën për të rifilluar të jetojë dhe të shpresojë. Po ashtu, do të agjërojmë për t'ia kërkuar Zotit këtë hir.

Është një detyrim dashurie, që lind prej faktit se jemi vëllazër e motra në Krishtin, përtej çdo largësie dhe kufiri kombëtar, për të qenë një Kishë e vetme.

Ju bekoj

Kronisti



PUNIMET NË KISHËN MJESJETARE TË SHËN BARBARËS NË PLLANË TË LEZHES

Kisha e Barbarës (Shën Barbullë) ndodhet në lindje të fshatit Pllanë, Bëdhan, (Lezhë), dhe ngrihet në lartësinë e kodrës mes një gjelbërimit. Ajo është një ndërtim i shek XIII-XIV-të i stilit romanik e shpallur monumente kulture në vitin 1973.

Në anën e jashtme kisha është trajtuar thjeshtë, ndërtuar me gurë të papunuar gëlqerorë dhe shtufi e shkatërruar herë nga pushtuesit Osman dhe herë nga tërmetet e ndryshme që kanë goditur vendin tonë. Është rindërtuar disa herë gjatë shekujve, si në vitin 1669, 1753 dhe së fundi 1916, kur qe dëmtuar rëndë nga Esadistët në vitin 1915.

Sipas relacionit të ipeshkvit të Lezhës, Nikollë Vlladanjit, të vitit 1694, Kisha ka pasur dy altarë: të Shën Barbarës dhe Zojës Rruzare, tre dyer, njëra ndër to ishte në hajatin Kishës dhe portiku e madh në hyrje të oborrit. Kishte kambanoren e madhe me një kambanë të madhe dhe dy të vogla. Ajo pas restaurimeve ishte në gjendje të mirë dhe frekuentohej nga 600 besimtar.

Kisha e Shën Barbarës martire e shek. IV, sot ruan pikturë mure në faqen perëndimore të Naosit dhe në atë lindore të Narteksit. Piktura në Naos ruhet në anën e djathtë të hyrjes perëndimore, ajo ka gjerësi 1.8 m dhe lartësi 1.95 m duke filluar në lartësinë 0.45 m nga dyshemeja. Piktura është realizuar në teknikën e afreskut në një support jo shumë të trashë. Skena paraqet Shën Jakovin Apostull dhe Shën Katarinen e Aleksandrisë dhe pjesën e hajatit ofron afreskun e Shën Gjergjit i cili vret dragoin dhe Shën Mëhilli Kryengjell që e mbyty vesin njeriut e keq. Në pjesën e altarit gjenden vizatime të thjeshta dekorative me motive biblike të realizuara në vitin 1941 nga ushtari italian, Bardini Renato.

Ky objekt ndërhyrjet e fundit nga Ministria e Kulturës i pati në vitin 2001 duke vendosur një çati provizore mbi atë vjetër. Dhe në vitin 2002, pati ndërhyrje në pjesët e brendshme duke sistemuar dyshemet dhe heqjen e suvatimit të brendshëm. Por më pas për 18 vite me radhe qe lenë në mëshirën e fatit duke u degraduar tejte skajshëm në çati e cila pikonte në çdo capë të saj dhe pikturat murale që dëmtoheshin për çdo momente nga kushte klimaterike dhe dëmtuesit pasi ishte pa dyer e dritare.

Objekti i gjendur në këtë situatë tmerruese, na nxiti që në qershor të këtij viti të fillojmë mbledhjen e donacioneve private për ta shpëtuar çfarë mund të shpëtohej. Dhe me 18 gusht të këtij viti, filluan punimet në rikonstruktimin dhe restaurimin e këtij objekti mesjetar me shumë vlerë, duke vendosur çatinë e re, ndërruar dyert dhe duke bërë fugime të nevojshme në muret e saj dhe shumë restaurime të tjera.





T. Çobani, N. Ballabani

TEATRI I FISHTËS

Botimet Fishta
Lezhë, 2020



Pren Buzhala

SHËN JERONIMI
DHE BOTA ILIRE

Botime Lena
Prishtinë 2020



At Benardin Palaj, OFM

BOTA E MALEVE
SHQIPTARE

Botime Françeskane
Shkodër 2018

KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 100 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXIII, nr. 9/10 (535-536) Shtator - Tetor 2020